



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA



KUVENDI NUK KONSTITUOHET AS NË TENTATIVËN E NJËMBËDHJETË



Kuvendi i Kosovës as në tentativën e njëmbëdhjetë nuk ka arritur të konstituohet. Kryesuesi Avni Dehari ka kërkuar sërish të hënën nga PDK-ja, LDK-ja, AAK-ja, Nisma

dhe Lista Serbe t'i propozojnë anëtarët për komisionin për zgjedhjen e kryeparlamentarit. Të njëjtat parti, ashtu sikurse në seancën e kaluar, nuk kanë propozuar asnjë anëtar, duke

kundërshtuar propozimin e LV-së që kryeparlamentari të zgjidhet në mënyrë të fshehtë. Seanca konstituive do të vazhdojë të mërkurën në orën 10:00

KURTI SËRISH I SHKRUAN LDK-së, E LUTË PËR KOALICION

F. 6




PËR LUAN HARADINAJN: FJALËT E SHPIRTIT DHE TË ZEMRËS

F. 6

Shkruan: Azem SYLA



AKTUALE



**TRUMPI KËRKON ZHBËRJEN E
PROGRAMIT BËRTHAMOR TË IRANIT,
POR SINJALIZON FLEKSIBILITET** F. 2

**BRUNEI HEQ VIZAT PËR QYTETARËT
E KOSOVËS** F. 3

**AMBASADORI GERARD MCGURK
MERR DETYRËN SHEF I RI I MISIONIT
TË OSBE-SË NË KOSOVË** F. 3


EKONOMI



**INVESTITORËT E HUAJ PËRBALLË
BUROKRACISË DHE MUNGESËS SË
PUNËTORËVE TË KUALIFIKUAR** F. 7

**AGIM SHAHINI: KRIZA POLITIKE PO
FUNDOS EKONOMINË, KËRKOJMË
VEPRIM URGJENT!** F. 7

SPORT



**SONTE VENDOSËT
FINALISTI I PARË** F. 10

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mok: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617

**Kolegji
BIZNESI**
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
030 500 870 | 045 500 870
044 500 870 | 049 500 870

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SHA
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Trumpi kërkon zhbërjen e programit bërthamor të Iranit, por sinjalizon fleksibilitet

UASHINGTON, 5 MAJ - Presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Donald Trump, ka thënë se objektivi i negociatave me Iranin është sigurimi i “zhbërjes së plotë” të programit bërthamor të Teheranit, por se do ta shqyrtonte mundësinë e lejimit të Iranit për ta mbajtur një program civil për energji bërthamore.

Në një intervistë me NBC, më 4 maj, Trumpi deklaroi se shpërbërja e programit bërthamor të Iranit do të ishte “krejt çfarë do të pranoja”.

Komenti përbën herën e parë që Trumpi ka thënë shprehimisht se çfarë dëshiron të bëjë me programin bërthamor të Iranit, që Teherani thotë se është paqësor.

Sekretari amerikan i Shtetit, Marco Rubio, sugjeroi javën e kaluar se Uashingtoni do të ishte i hapur për ta lejuar Iranin të operojë një program paqësor civil bërthamor, duke thënë se “ekziston një mënyrë për ta bërë këtë”. “Dhe, kjo mënyrë është ndërtimi i reaktorëve dhe

importimi i uraniumit të pasuruar për vënien në funksion të këtyre reaktorëve. Kështu veprojnë dhjetëra vende nëpër botë”, tha ai për “Fox News”, më 1 maj.

Trumpi u duk se u bëri jehonë komenteve të Rubios, duke i thënë NBC-së se do të ishte “i hapur për ta dëgjuar atë”. “Quhet energji civile. Por, siç e dini, energjia civile shpesh çon në luftëra ushtarake. Dhe, ne nuk duam që ata të kenë armë bërthamore. Është shumë e thjeshtë”, shtoi ai.

Trumpi tha se një program civil bërthamor do të përdorej për prodhim të energjisë elektrike, por duke marrë parasysh se Irani është vend i pasur me energji, atij vërtet nuk do t’i duhej ai. “Jam i prirë të them, ‘Për çfarë ju duhet ai? Keni mjaft naftë’”, shtoi ai.

Jason Brodsky, drejtor politikash në organizatën United Against Nuclear Iran (Të bashkuar kundër Iranit bërthamor), deklaroi se komentet e Trumpit e kanë bërë të qartë se administrata



nuk është e interesuar për një version të ri të marrëveshjes bërthamore të 2015-s me Iranin. “Kjo intervistë e vë në pikëpyetje atë fantazi”, shkroi ai në rrjetin social X.

Ndërkohë, të tjerë ngulmojnë se thirrja e Trumpit për zhbërjen e programit bërthamor të Iranit, teksa në të njëjtën kohë vazhdon të jetë i hapur për mundësinë që Irani të operojë një program civil të energjisë bërthamore, sugjeron

se ai është ende i pavendosur. “Mbase mund të argumentohet se ekipi i Trumpit ende nuk e di saktësisht se çfarë do nga Irani, por ai vetë e dëshiron një marrëveshje ndryshe” nga ajo e 2015-s, shkroi analisti i politikës së jashtme me bazë në Iran, Rahman Qahremanpour. Irani ka hedhur poshtë thirrjet për zhbërjen e programit të tij bërthamor dhe për heqjen dorë nga aftësia e tij për pasurimin e uraniumit.

Duke iu përgjigjur komentit të Trumpit, një zëdhënës i Ministrisë së Jashtme të Iranit tha më 5 maj se Irani “ka të drejtë për energji paqësore bërthamore”, dhe hodhi poshtë komentin e presidentit amerikan për naftën. “Programi paqësor bërthamor i Iranit daton nga vitet ’70, kur Irani kishte më shumë karburante fosile dhe më pak konsum”, tha Esmail Baqaei në një konferencë të përjavshme për medie. “Prandaj, disa komente të gabuara për qasjen e Iranit në rezerva të mëdha të karburanteve fosile dhe mosnevojën për energji bërthamore nuk mbështeten në shkencë apo realitet”, shtoi ai.

Irani dhe Shtetet e Bashkuara kanë zhvilluar tri raunde diskutimesh bërthamore që nga muaji i kaluar. Një raund i katërt, me ndërmjetësimin e Omanit, ishte paraparë të mbahej më 2 maj, në Romë, por u shty për shkak të atyre që Muskati i quajti “arsye logjistike”.

Padi ndaj Dodikut, akuzohet për fyerjen e boshnjakëve

SARAJEVË, 5 MAJ - Nënpresidenti i Federatës së Bosnjë-Hercegovinës, Igor Stojanović, njoftoi më 5 maj se ka dorëzuar padi në Zyrën e Prokurorit të Bosnjë-Hercegovinës kundër presidentit të entitetit Republika Srpska, Millorad Dodik, mbi dyshimet se ka kryer veprën penale të nxitjes së urrejtjes kombëtare, racore dhe fetare.

Stojanovići tha, në një postim në “Facebook”, se Dodiku ka bërë deklarata gjatë paraqitjeve publike, të cilat fyen dinjitetin e boshnjakëve dhe “shkelën të drejtën e fesë dhe kulturës, dhe liritë themelore, që garantohen nga Kushtetuta dhe e drejta ndërkombëtare”.



Duke folur para gazetarëve, më 29 prill, pas një takimi të koalicionit qeverisës në Republikën Srpska, Dodiku paraqiti tezën që zgjidhje për

Bosnjë-Hercegovinën është që boshnjakët “të kthehen në fenë e paraardhësve të tyre, që Bosnjë-Hercegovina të jetë me shumicë serbe”.

Duke mohuar identitetin e boshnjakëve, ai i fyeu ata duke i quajtur “të konvertuar”.

Stojanovići theksoi se ai ka obligim “institucional dhe moral që të reagojë kur kërcënohen themelet e shtetit - barazia, siguria dhe dinjiteti i qytetarëve të saj”. “Heshtja përballë gjuhës së urrejtjes nuk është opsion. Bosnjë-Hercegovina është shtet i të gjithë njerëzve dhe qytetarëve të tij. Themelet e saj janë mbi luftën kundër fashizmit, mbi lirinë dhe barazinë. Është patriotizëm ta mbrosh dinjitetin e çdo qenieje njerëzore dhe t’i mbrosh vlerat mbi të cilat bazohet ky vend”, theksoi ai.

Nenet e Kodit Penal të Bosnjë-Hercegovinës ndalojnë “nxitjen publike dhe nxitjen e urrejtjes kombëtare, racore apo fetare”, dhe parashohin dënim me burgim.

Dodiku është në kërkim nga Gjykata e Bosnjë-Hercegovinës dhe nga Zyra e Prokurorit të Bosnjë-Hercegovinës për shkak se ai po refuzon të përgjigjet për marrje në pyetje për “sulm ndaj rendit kushtetues të vendit”.

Fletarrestim është lëshuar edhe për kryetarin e Asamblesë së Republikës Srpska, Nenad Stevandić, dhe për kryeministrin e entitetit, Radovan Višković, të cilët, po ashtu, dyshohet ta kenë kryer krimin e njëjtë.

Ultranacionalisti Simion përballë të moderuarit Dan në balotazhin presidencial në Rumani

BUKURESHIT, 5 MAJ - Ultranacionalisti George Simion siguroi një fitore solide në raundin e parë të zgjedhjeve presidenciale në Rumani, por ai nuk arriti ta marrë shumicën e nevojshme për të shmangur një përballje balotazhi me prefektin e Bukureshtit, Nicusor Dan.

Pas numërimit të të gjitha fletëvotimeve në mëngjesin e 5 majit, Simion, udhëheqës 38-vjeçar i partisë AUR, doli i pari

me 40.96 për qind, apo 3 860 000 vota, sipas Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të Rumanisë.

Dan, 55-vjeçar, i konsideruar politikan i moderuar, kaloi Crin Antonescun, pjesëtar i koalicionit qeverisës të vendit, për ta zënë vendin e dytë, i ndihmuar nga votat nga diaspora.

Dan mori 20.99 për qind të votave, kurse Antonescu 20.07 për qind.

Rreth 973 000 njerëz votuan në diasporë, treguan të dhënat.

Simion doli i pari edhe me votat nga diaspora. Ai mori 61 për qind të tyre, i ndjekur nga Dan me 26 për qind dhe Antonescu me 6.8 për qind. “Jemi në raundin e dytë. Faleminderit”, shkroi Dan në “Facebook”.

Anketat pas votimit kishin sugjeruar rezultate të ngjashme të përgjithshme, ndonëse ato i jepnin Simionit një epërsi më të vogël.



AMBASADORI GERARD MCGURK MERR DETYRËN SHEF I RI I MISIONIT TË OSBE-SË NË KOSOVË

PRISHTINË, 5 MAJ - Ambasadori Gerard McGurk, diplomat karriere në Shërbimin Diplomatik Britanik, është emëruar shef i Misionit të OSBE-së në Kosovë dhe të hënën ka marrë zyrtarisht detyrën e re. Përvoja diplomatike e ambasadorit McGurk përfshin angazhim të gjerë në menaxhim të krizave, marrëdhënie ndërkombëtare bilaterale dhe multilaterale në rajone të ndryshme, nga Madridi, Amani, në Shkup e Kombe të Bashkuara në Nju-Jork. Ambasadori McGurk ka qenë pjesë e Ekipit të Qeverisë Britanike për Statusin Final në kuadër të punës së të Dërguarit të Posaçëm të OKB-së, Martti Ahtisaari (2005-2007). “Këto përvoja kanë formësuar qasjen time ndaj diplomacisë, duke u fokusuar në dialog gjithëpërfshirës, partneritet, respekt dhe bashkëpunim.

Këto vlera janë të rrënjësura thellës në punën e OSBE-së këtu. Si shef i ri i Misionit jam i përkushtuar ta vazhdoj punën e jashtëzakonshme të paraardhësve të mi në përbushjen e mandatit thelbësor të Misionit, gjegjësisht përmirësimin e qeverisjes së mirë, mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut dhe të komuniteteve, si dhe rritjen e sigurisë publike për të gjithë”, tha ambasadori McGurk.

Ambasadori McGurk ka punuar më parë zëvendës drejtor dhe shef i Departamentit për Siguri dhe Reziliencë në Zyrën për Punë të Jashtme, Komonuelth dhe Zhvillim (FCDO), si dhe zëvendës drejtor për Rrjet dhe Performancë.

Ai ka udhëhequr sektorin konsullor në Task Forcën për Afganistanin në Londër, duke luajtur rol kritik lidhshpër në kohë krize gjatë evakuimit



ndërkombëtar nga Kabuli në periudhën gusht-shtator 2021. Po ashtu, ka qenë pjesë e Misionit të Mbretërisë së Bashkuar në OKB në Nju-Jork si përfaqësues i qeverisë britanike në komitetet për sanksione ndaj Irakut dhe Al-Kaidës. Në verën e vitit 2003 është deleguar në Irak për të

punuar me Autoritetin e Përkohshëm të Koalicionit (CPA). Angazhimi i tij i parë jashtë vendit ishte në Ambasadën Britanike në Athinë, Greqi, në vitin 1991. Ambasadori McGurk ka përfunduar studimet master në Administrim Biznesi (MBA) në Universitetin Open në MB.

Përveç gjuhës së tij amtare, anglishtes, e flet edhe maqedonishten dhe pak spanjisht. Është i martuar dhe ka dy fëmijë të rritur. Në rolin e tij shef i Misionit të OSBE-së në Kosovë vjen pas ambasadorit Michael Davenport të Mbretërisë së Bashkuar.

FILLOJNË PUNIMET PËR MODERNIZIMIN DHE ZGJERIMIN E INFRASTRUKTURËS FIKSE ME FIBRA OPTIKË NË RRJETIN E TELEKOMIT

FUSHË KOSOVË, 5 MAJ - Kryeministri në detyrë, Albin Kurti, bashkë me ministren në detyrë të Ekonomisë, Artane Rizvanolli, vizituan të hënën fillimin e punimeve për shtrirjen e rrjetit optik të Telekomit të Kosovës, një projekt strategjik që shënon një hap të rëndësishëm në modernizimin e shërbimeve fikse të komunikimit në të gjithë territorin e vendit. Gjersa u prit nga kryeshefja ekzekutive e Telekomit të Kosovës, Burbuqe Hana, së bashku me drejtorin teknik Halil Krasniqi, anëtarë të Bordit të Drejtorëve dhe kryetarin e Sindikatës së Telekomit, Lamih Balaj, kryeministri Kurti u informua për detajet teknike, hapësirën gjeografike që do të mbulohet dhe ndikimin konkret që ky investim do të ketë në cilësinë e shërbimeve për qytetarët dhe bizneset. Projekti përfshin zgjerimin e rrjetit optik në tërë territorin e vendit, duke mundësuar qasje në: internet me shpejtësi të lartë (fiber), shërbime të



avancuara televizive (IPTV/OTT) e linja moderne telefonike. “Po e bëjmë vendosjen e fibrave optikë këtu në Fushë-Kosovë që do të jetë shumë i dobishëm si për amviseritë, ndërtesat banesore, gjithashtu edhe për zonat industriale për bizneset e vendit tonë. Telekomin e Kosovës kjo udhëheqje e ka gjetur në 50 milionë euro borxhe, dhe në vitet 2023 dhe 2024, së bashku e kanë kthyer

në një ndërmarrje fitimprurëse me 15 milionë euro fitim, dhe që është veçanërisht e rëndësishme, në fund të vitit të kaluar, bashkë me gigandët e teknologjisë nga Suedia dhe nga Kroacia, Ericsson dhe Tesla, kemi bërë modernizimin e rrjetit dhe e kemi mbuluar gjithë territorin e republikës, përfshirë edhe katër komunat në veri të lbrtit, me rrjetin 4G dhe 5G”, tha kryeministri. Ai shtoi se punimet po fillojnë

në Fushë-Kosovë e do të shtrihen anembanë territorit të vendit, gjersa falënderoi ministren Rizvanolli, kryeshefen Burbuqe Hana, menaxhmentin, bordin dhe të gjithë punëtorët e Telekomit për këtë rezultat të përbashkët, për cilësinë e shërbimeve në rritje dhe çmimet e përbalueshme. “Po ashtu, jemi larguar prej disa operatorëve të ndryshëm të cilët na kanë pajisur me teknologji prej vendeve të cilat

nuk janë mike me Kosovën dhe e kemi bërë zëvendësimin, tash çdo gjë e kemi me shtetet anëtare të Bashkimit Evropian e të NATO-s dhe Telekomit i Kosovës do ta ketë përkrahjen e aksionarit, pra Qeverisë së Republikës, për të vazhduar, për ta shtrirë rrjetin e optimizuar edhe më tej, pra edhe fiks edhe mobil”, u shpreh kryeministri Kurti. Kryeshefja Hana falënderoi qeverinë për mbështetjen dhe theksoi përkushtimin e Telekomit për të vazhduar me rezultate konkrete e investime të zgjuara, ndërsa nga bordi i Telekomit u theksua përkrahja nga ana e qeverisë dhe mbështetja deri në arritjen e operimit me fitim të Telekomit të Kosovës dhe investimeve që janë zhvilluar në rrjetin mobil e tashmë po zhvillohen në atë fiks përmes fibrave optikë. Kryetari i Sindikatës së Telekomit, Lamih Balaj, gjithashtu falënderoi edhe punëtorët e Telekomit për punën e tyre dhe angazhimin dhe qeverinë për mbështetjen.

Brunei heq vizat për qytetarët e Kosovës

Prishtinë, 5 maj - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka njoftuar se Brunei ka hequr vizat për qytetarët e Kosovës. “Sot, së bashku me Sulltanin e Bruneit, Haji Hassanal Bolkiah

nënshkruam marrëveshjen për heqjen vizave ndërmjet Kosovës dhe Bruneit, një hap domethënës drejt afrimit dhe bashkëpunimit më të ngushtë ndërmjet dy shteteve tona. Kjo

marrëveshje nuk është vetëm lehtësim teknik, por një urë miqësie e ndërtuar mbi respektin dhe mirëbesimin e ndërsjellë”, ka shkruar Osmani në “Facebook”.





KUVENDI NUK KONSTITUOHET AS NË TENTATIVËN E NJËMBËDHJETË

Kuvendi i Kosovës as në tentativën e njëmbëdhjetë nuk ka arritur të konstituohet. Kryesuesi Avni Dehari ka kërkuar sërish të hënën nga PDK-ja, LDK-ja, AAK-ja, Nisma dhe Lista Serbe t'i propozojnë anëtarët për komisionin për zgjedhjen e kryeparlamentarit. Të njëjtat parti, ashtu sikurse në seancën e kaluar, nuk kanë propozuar asnjë anëtar, duke kundërshtuar propozimin e LV-së që kryeparlamentari të zgjidhet në mënyrë të fshehtë. Seanca konstituive do të vazhdojë të mërkurën në orën 10:00

**EPOKA
ERE****Mal QORRAJ**

PRISHTINË, 5 MAJ - Për të njëmbëdhjetën herë me radhë deputetët e Kuvendit të Kosovës kanë dështuar ta konstituojnë përbërjen e nëntë parlamentare të dalë nga zgjedhjet e shkurtit. Ligjbërësit refuzuan për të tretën herë rresht që ta formojnë një komision për votimin e fshehtë për kreun e ri të organit ligjvënës. Dështimi i radhës ndodhi pak para se të bëhej me dije që kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje (LV), njëherësh kryeministër në detyrë i Kosovës, Albin Kurti, i ka shkruar një letër kreut të Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), më 5 maj, përmes së cilës e ka ftuar për marrëveshje politike. Në vazhdimin e seancës konstituive, të hënën, Partia Demokratike e Kosovës (PDK),

Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK-ja), Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dhe Lista Serbe refuzuan sërish të propozojnë një përfaqësues që do ta siguronte mbarëvajtjen e votimit të fshehtë. Seanca konstituive do të vazhdojë të mërkurën në orën 10:00. Deputetë të partive që në legjislaturën e kaluar ishin në opozitë thonë se është jokushtetuese mënyra se si LV-ja po tenton që kryeparlamentari të votohet përmes formës së fshehtë. Kreu i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka paralajmëruar se deputetët mund t'i drejtohen Gjykatës Kushtetuese. Deri më tani deputetët kanë kaluar vetëm dy pika të agjendës së seancës konstituive: raportin e Komisionit të Përkohshëm për Verifikimin e Mandateve dhe

atë të Betimit të Deputetëve. Por, procesi ka ngecur te pika e tretë: zgjedhja e kryeparlamentarit. Propozimi për kryeparlamentar është e drejtë ekskluzive e fitueses së zgjedhjeve, LV-së, por në gjashtë votime, kandidatja e saj, Albulena Haxhiu, nuk ka arritur t'i marrë votat e nevojshme, përkatësisht 61. Partitë që po kundërshtojnë emrin e Haxhiut për kryeparlamentarë i kanë kërkuar LV-së ta ndryshojë propozimin për të në mënyrë që procesi të zhbllloket. Deputeti i PDK-së, njëherësh kryetar i kësaj partie, Memli Krasniqi, tha pas dështimit të radhës për konstituimin e Kuvendit, se LV-ja, "në mungesë të shumicës parlamentare, është duke dhunuar jo vetëm këtë institucion, por edhe vetë shtetin". Krasniqi ka thënë se

po duket që për kreun e LV-së, Kurtin, "Haxhiu është më e rëndësishme se qytetarët që kanë votuar në zgjedhje dhe kanë dhënë verdiktin e tyre". "Në mungesë të besimit, në mungesë të numrave, në mungesë të shumicës për t'u bërë vetë kryeministër, ai po luan me Albulena Haxhiun...", është shprehur Krasniqi. Kurti, sipas tij, "e ka më të lehtë ta sakrifikojë atë sesa që të matet vetë. Secili e di që ai nuk i ka numrat". Krasniqi ka thënë se LV-ja "nuk mund ta mbajë peng me zor shtetin". "Nëse vërtet dëshiron të kemi rrugëdalje, e ftoj ta ndryshojë kandidaten", ka thënë ai. Deputeti i LV-së, Hekuran Murati, ka thënë se "vullneti i deputetit po vazhdon të ndrydhet përmes insistimit për votim të hapur". "Votimi i fshehtë është mënyrë kushtetuese si të dilet nga situata", është shprehur ai. Sipas Murati, partitë opozitare vazhdojnë të mos u besojnë deputetëve të tyre. Ai ka theksuar se votimi i fshehtë nuk përbën kurrfarë shkelje. Murati ka thënë se LV-ja është e interesuar që me partitë e tjera të gjejë pajtim për rrugën përpara, teksa ka konfirmuar

se ajo është e hapur për "diskutim për marrëveshje politike". Deputeti i LDK-së, Arben Gashi, ka thënë se bllokimi i Kuvendit është pasojë e mosbashkëpunimit në mes të LV-së dhe partive që dikur ishin në opozitë. Ai ka thënë se "nuk ka mirëbesim mes partive politike" dhe se kjo "është për keqardhje". Sipas tij, mirëbesimi mund të arrihet "vetëm me veprime konkrete nga Kurti". Ai ka kërkuar që Kurti të kërkojë falje "për gjuhën ofenduese dhe sjelljen degraduese" dhe të marrë përgjegjësi për gjendjen e vendit sot. Kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, ka deklaruar se është përgjegjësi e tri partive politike më të mëdha në vend për ta tejkaluar këtë krizë. Sipas tij, Nisma do të japë kontributin e saj që vendi të mos ketë krizë institucionale. Limaj, pas dështimit të 11-të të konstituimit të Kuvendit të Kosovës, i ftoi partitë e mëdha të marrin kohë dhe të gjejnë zgjidhje. "Besoj se tashtme janë bërë të gjitha ushtrimet, taktizimet, që janë normale. Ndonjëherë në politikë është një gjendje e qartë se cili është raporti i forcave në parlament."

KURTI SËRISH I SHKRUAN LDK-së, E LUTË PËR KOALICION

PRISHTINË, 5 MAJ - Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje (LV), njëherësh kryeministër në detyrë i Kosovës, Albin Kurti, i ka shkruar një letër kreut të Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), më 5 maj, përmes së cilës e ka ftuar për marrëveshje politike mes dy partive. Kurti e ka ftuar Lumir Abdixhikun që LV-ja dhe LDK-ja të bëjnë koalicion qeverisë, i cili do t'i hapte rrugë zhbllokimit të Kuvendit të Kosovës dhe formimit të Qeverisë së re të Kosovës. Letra u bë publike pas dështimit të përpjekjes së njëmbëdhjetë për konstituimin e Kuvendit. Disa orë pas dërgimit të letrës nga Kurti, Abdixhiku ka thënë se partia e tij do t'i përgjigjet asaj zyrtarisht. Duke folur para gazetarëve, ai ka thënë se letrën nuk e ka parë ende, por se do të kthejë përgjigje “me kohë”. Ai u ka kërkuar anëtarëve të partisë së tij që “gjendjen e tanishme ta trajtojnë pa arrogancë shumë”. Në letër Kurti ka shkruar se është “i interesuar dhe i vullnetshëm për marrëveshje politike me LDK-në”. Kurti i ka thënë Abdixhikut se “koalicionet bëhen pikërisht ndërmjet atyre që kanë dallime”, teksa ka shkruar se ka bindjen që “votuesit e LDK-së sot e preferojnë më së shumti koalicionin me LV”. “Edhe votuesit e LV-së e preferojnë po ashtu më së shumti koalicionin me LDK. Pse të mos e bëjmë”, është shprehur Kurti në letrën drejtuar Abdixhikut. Kreu i LV-së në letër nuk e ka përjashtuar as gatishmërinë e partisë së tij për shkuarje në



zgjedhje të reja, por ka thënë se edhe ato do të çonin drejt një koalicioni në mes të LV-së dhe LDK-së. “Pse ta bëjmë atëherë më vonë, kur mund ta bëjmë tash?”, e ka pyetur Kurti, Abdixhiku. Analisti politik nga Prishtina, Artan Muhaxhiri, tha në një intervistë për “Radion Evropa e Lirë” se mënyra e formulimit të letrës së kreut të Lëvizjes Vetëvendosje (LV), Albin Kurti, drejtuar Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), “është jashtëzakonisht dinake”. Sipas tij, kjo letër është më shumë një veprim formal, me synimin

për ta përmirësuar imazhin bashkëpunues në opinionin publik sesa që ka një peshë reale dhe konkrete. Edhe Ismet Kryeziu, drejtor i KDI-së, e ka komentuar letrën e Kurtit dërguar Abdixhikut. “Sot Kurti i paska shkruar sërish Abdixhikut, kësaj here jo vetëm për konstituimin e institucioneve, por për një koalicion qeverisë. Një letër që, për nga përmbajtja, lë shumë për të dëshiruar, sidomos kur vjen nga një ish-kryeministër, a kryeministër në detyrë dhe lider i subjektit më të madh politik. Pra, është e

lehtë ta refuzosh letrën për gjuhën dhe qasjen e papërshtatshme. Por më e rëndësishme është të mos refuzojmë mundësinë për dialog ndërpartiak. LDK-ja duhet të veprojë politikisht jo për t'i shërbyer LV-së, por për të mos i shërbyer krizës së zgatur politike dhe institucionale”, ka shkruar ai në “Facebook”. Ish-deputeti i Kuvendit të Kosovës, Burim Ramadani, ka thënë se letra e fundit e Kurtit për LDK-në është faza e re për përçarjen e partive shqiptare. “E filloi me Nisma-n për të

njëjtin qëllim, por nuk bëri shumicën. Po vazhdon synimin ndaj LDK-së krejtësisht njëjtë! Kjo nuk është logjikë shtetërore. Është logjikë përçarëse vetëm e vetëm për të mbajtur pushtet. Por, pushteti nuk mbahet me patjetër. ‘O unë, o askush!’. Politikani duhet të ketë parime e dinjitet! Kur nuk ke shumicë, thjesht pranor realitetin. Kthehesh në opozitë dhe bëhesh gati për zgjedhjet tjera kurdo që janë! Kaq, e thjeshtë është demokracia. Shumica qeveris!”, ka shkruar Ramadani në “Facebook”.

Ftesa ime është për tri partitë e mëdha që ta marrin kohën e duhur sa iu duhet, të gjejnë rrugë edhe ligjore dhe të gjejnë një zgjidhje e cila do të çonte në krijimin e institucioneve të Kosovës, të parlamentit dhe qeverisë. Tashmë besoj se për secilin është e qartë tema këtu është qeveria e jo vetëm kryetari i Kuvendit”, thotë Limaj. Sipas tij, këto vonesa janë të panevojshme dhe sa më shpejt duhet të gjendet një marrëveshje politike. “Kjo kështu është një reprizë e panevojshme, një vonesë e panevojshme. Duhet të gjenden rrugë, dhe rrugët gjenden përmes marrëveshjeve politike, përmes kompromiseve. Kosova duhet ta shohë një shumicë parlamentare, e nëse partia e parë nuk e ka shumicën, atëherë le ta bëjnë të tjerët shumicën, ama një shumicë duhet të bëhet dhe përgjegjës në po e them e kanë

tri partitë e mëdha për ta nxjerrë vendin nga kriza. Nisma do të jetë këtu për ta dhënë kontributin e vet që Kosova mos të ketë krizë institucionale dhe kjo është ajo që mund të bëjmë tani për tani”, thotë ai. Kreu i Nismës, Limaj, tha se derisa 61 vota janë problem të sigurohen, s’mund të mendohet për çështjen e presidentit.

Pse po kundërshtohet Albulena Haxhiu?

Haxhiu po konsiderohet figurë përçarëse nga dy parti parlamentare, PDK-ja dhe AAK-ja. Këto dy subjekte kanë kërkuar që LV-ja të nxjerrë emër tjetër për kryeparlamentar, madje AAK-ja ka përmendur edhe dy emra - Saranda Bogujevcin dhe Shqipe Selimin - nga partia e kryeministrit në detyrë, Kurti, të cilat ka thënë se do t'i

votonte. LDK-ja, ndërkaq, ka thënë se nuk ka vota për asnjë të propozuar të LV-së për pozitën e kryeparlamentarit. Por, LV-ja ka argumentuar se Haxhiu është kandidatë meritore dhe ka refuzuar thirrjet për të vendosur dikë tjetër në emër të saj. Partitë, që në legjislaturën e kaluar ishin në opozitë, e kanë akuzuar LV-në se po synon ta imponojë votimin e Haxhiut dhe me “qëllim po bllokoi procesin”, pasi kanë argumentuar se kjo parti nuk i ka as votat për Qeverinë e re të Kosovës - proces që pason konstituimin e Kuvendit - për formimin e së cilës, po ashtu, kërkohet shumica e thjeshtë prej 61 votash. Por LV-ja ka thënë se nuk po i detyron partitë ta mbështesin kandidaten e saj për kryeparlamentare. Kjo parti ka thënë se nuk është e interesuar për mbajtjen e zgjedhjeve të reja, por është e gatshme për

një cikël të ri zgjedhor, si opsion i fundit për dalje nga situata e krijuar. LV-ja më herët ka propozuar që së bashku me PDK-në dhe LDK-në të pajtohen që të votohen në paketë Haxhiu dhe tre nënkryetarët e Kuvendit - teksa dy nënkryetarët të tjerë u takojnë komuniteteve pakicë. Në zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit, LV-ja i ka fituar 48 ulëse në Kuvend, PDK-ja 24, LDK-ja 20, AAK-Nisma tetë, tri prej të cilave i takojnë kësaj të fundit dhe kjo ndarje e ulëseve në Kuvend ia pamundëson secilës parti që të qeverisë e vetme. Formimin e institucioneve të reja po e kërkon bashkësia ndërkombëtare - Bashkimi Evropian - që ka thënë se Kosova duhet t'i formojë shpejt institucionet e reja. Ndërkaq, më 30 prill, ambasadori gjerman në Kosovë, Jorn Rohde, ka shprehur shqetësimin e tij për vonesat në krijimin e

institucioneve. Ai u ka bërë thirrje partive politike të veprojnë shpejt në këtë drejtim dhe t'i shohin interesat shtetërore para atyre partiake. Seanca konstituive, që ka nisur më 15 prill, mund të ndërpritet dhe të vazhdohet sërish brenda 48 orësh. Nuk ka kufizime se sa vazhdimë mund të ketë deri në konstituimin e organit ligjvënës. Votimi i kryeparlamentarit dhe nënkryetarëve do t'i hapte rrugë formimit të Qeverisë së re të Kosovës. LV-së, si fituese të zgjedhjeve, i takon që e para ta propozojë mandatarin për ekzekutivin. Nëse brenda 15 ditësh nuk e formon ekzekutivin, atëherë presidentja Vjosa Osmani ka të drejtë ta mandatojë cilëndo parti që i garanton se i ka 61 votat për Qeverinë e re të Kosovës. Nëse edhe mandatar i dytë dështon ta formojë ekzekutivin, atëherë Osmani shpall mbajtjen e zgjedhjeve të reja.

KOMANDANTI I PËRGJITHSHËM I UÇK-SË, AZEM SYLA, PËRKUJTON DËSHMORIN E PARË TË UÇK-SË TË RËNË NË LUFTËN E PARË UÇK - SERBI NË VIJËN KUFITARE, GJENERAL LUAN HARADINAJN, NË PËRVJETORIN E RËNIES (6 MAJ 1997)

PËR LUAN HARADINAJN: FJALËT E SHPIRTIT DHE TË ZEMRËS

- Një figurë luani që dua ta kujtoj sot është Luan Haradinaj;
- Zjarr i lëshonin sytë, megjithëse dukej shumë i qetë. Ai shkonte në detyrë sikur po shkonte të kryente një punë të zakonshme;
- Luani kur ra për të kaluar në pedestalin kombëtar ishte vetëm 23-vjeçar, por ishte rritur aq shumë, sa të ishte një ndër udhëheqësit e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës



Shkruan: Azem SYLA

Njeriu është edhe me fat edhe kalon nëpër shumë disfata në jetë. Unë kam pasur shumë fat që jam njohur, kam vepruar e kam luftuar me shumë djem e burra, nëpër rrugën e luftës për çlirimin e atdheut, por jam edhe zemërthyer sepse nëpër ato rrugë të zjarrta shumë shokë më kanë mbetur në themelet e luftës duke u bërë pishtarë të përjetshëm të ndriçimit të atdheut nëpër kohë.

Një figurë luani që dua të kujtoj sot është Luan Haradinaj. Ai që ishte dhe dukej i ri, por që ishte me një fuqi që impononte nderim dhe pasqyronte qëndrueshmëri dhe pathyeshmëri në çdo veprim e në çdo aksion që ndërmerrete. Luanin e kam njohur në ato kohë kur Ushtria Çlirimtare e Kosovës po hidhte themelet e saj në gjithë hapësirat e Kosovës dhe po merrte formë e po krijonte portretin e saj duke përcaktuar përgjegjësitë për çlirimin e vendit. Ai banonte në një lagje të Tiranës. Informacionin e parë për Luanin ma pati dhënë Halim Krasniqi. Në atë banesën ku banonte edhe familja e shtëpisë e njithe me emrin "Studenti". Kushdo që pyeste, e këdo që të pyesje thoshin: a po, ai studenti. Megjithëse edhe pa e takuar unë kam pasur njohje edhe më herët për Luanin nëpërmjet Nait Hasanit, i cili e portretizonte si një nga figurat më të spikatura të atij organizimi luftarak që po realizohej në Kosovë prej vitit 1994 e në vijim, për të realizuar masivizimin e Ushtrisë Çlirimtare dhe për ndërmarrjen e hapit për çlirimin e vendit.

Edhe në këtë kohë kur jemi takuar, Luani, pavarësisht se ishte me qëndrim në Tiranë ai bënte jetë gjysmë ilegale. Sillej me kujdes dhe nuk dukej të qëndronte në mjedise të zhurmshme.

Kujtoi se më herët Luani i kishte pasur lidhjet e veprimtarisë me Xhavit Halitin. Ndërsa diku në vitet 1995 – 1996 Xhaviti më takoi me Luanin dhe më tha që të


vijojmë të punojmë e veprojmë bashkë. E prej këtej mund të them se lidhja jonë u forcua edhe më shumë, kur bashkë me ne po vepronte edhe Sokol Poga. Me Sokol Pogën u njohëm po në atë kohë në veri të Shqipërisë në Krumë, përkatësisht në shtëpinë bazë të UÇK-së te Alush Dragusha. Një bazë që Luani me Sokolin e kishin krijuar me kohë dhe që do të shërbente me devotshmëri gjatë gjithë luftës, duke na hapur rrugën që në shërbim të Luftës Çlirimtare të Kosovës të vihej gjithë fshati Vlahën e më gjerë.

Në veri unë e Sokol Poga kuptoheshim plotësisht me Luanin, i cili ishte vërtetë shumë luftarak, me vizion dhe me dëshirë të zjarrtë për luftë. Ai ishte një luftëtarë me autoritet. Të gjithë ata burra që vepronin me të e nderonin dhe ia zbatonin me shpejtësi e saktësi detyrat që vinte. Por ai ishte vetë luftëtarë që i kryente detyrat e tij pa u lëkundur dhe pa u menduar dy herë.

Kujtoi se më dukej që këtej nga veriu njerëzit janë kuriozë. Ata shpesh pyesnin: ky djalë i ri kush është e çka bën. Ndoshta edhe më dukej mua, sepse në atë kohë ne vepronim në fshehtësi të plotë. Por di se kur na pyesnin gjithnjë u thoshim: është student në Tiranë dhe shkon kur ka nevojë te shtëpia e vet (apo te prindërit) dhe kthehet në shkollë në studime të fakultetit të kulturës fizike, në universitetin e Tiranës. Dhe ai vërtetë që ishte student në atë fakultet, pavarësisht se prioritet kishte veprimtarinë luftarake në kuadër të UÇK-së.

Luani ishte i qartë për punën që bënte për ditë e për natë me përkushtim atdhetari. Ai ishte i bindur se shqiptarët do ta mbështesnin Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, ishte i bindur se zjarri i luftës do ta përfshinte Kosovën dhe do të arrihej çlirimi. Jam bindur plotësisht se Luani pavarësisht moshës së re, kishte një pjekuri burri, por kishte edhe një fuqi imponuese ushtaraku dhe pavarësisht se nuk kishte studiuar në shkolla ushtarake, shihej në çdo fjalë e veprim se ishte i lindur për të qenë luftëtarë e komandant luftëtarësh.

Me Luanin kemi ecur shumë në atë kohë. Për të nuk kishte detyrë të pa realizueshme. Ai ishte



shumë pozitiv. Asnjëherë nuk i shihte punët me shqetësim. Për të sido që të zhvilloheshin situatat, kishte zgjidhje për të dalë atë ku duhej e për të bërë atë që duhej në atë çast.

Çdo gjë që duhej për përgatitjen logjistike, për aksione kundër forcave policore e ushtarake e të shërbimit sekret (UDB-es) dhe të atyre që ndihmonin regjimin serb të Milosheviçit, për Luanin ishin detyra dhe punë që duheshin kryer dhe do të kryheshin në kohën e duhur dhe pa asnjë mungesë pavarësisht vështirësive të asaj kohe që ishin shumë të mëdha. Nuk besoj se kishte vështirësi sado të dukej, që të mund ta ndalte Luanin për të kryer detyrat që kishte marrë mbi vete. Ai ishte shumë i saktë në veprimet e tij, shumë dinamik dhe i pa lodhshëm, shumë energjik. Ishte aq ndikues sa mund të them se të gjithë ata që vepronin me të, pranë tij a nën udhëheqjen e tij, do të bënin të gjitha përpjekjet që të punonin e vepronin si ai. Përpiqeshin t'i ngjanin.

Kujtoi se diku në shkurt të vitit 1996 jam takuar me Sokol Bashotën, Daut Haradinajn dhe Mujë Krasniqin. Dhe në atë takim kam mësuar se Luani e kishte vëlla Dautin, por asnjëri prej tyre nuk e shfaqnin as para meje dhe para askujt që janë vëllezër. E kujtoi këtë si një nga çastet kur madhështia e këtyre djemve për mua nuk ka pasur kufi. Ata vepronin bashkë, luftonin bashkë, i kryenin detyrat bashkë dhe nuk shfaqnin asnjëherë dobësinë e vëllait për vëllanë, dashurinë e vëllait për vëllanë, kujdesin e vëllait për vëllanë. Ata vërtetë ishim modeli i luftëtarit, modeli se si duhet të jenë çlirimtarët. E ruaj këtë të vërtetë në shpirt me një dashuri e kujdes të madh, se më është dukur gjithnjë si diçka e shenjtë.

Mund të them pa menduar se gaboj, që Luani e shihte Kosovën e çliruar. Prandaj edhe dukej sikur vraponte për t'i kryer detyrat e luftës sa më parë për ta arritur atë që shihte. Ai nuk e njithe vdekjen, nuk i shkonte mendja se mund të ekzistonte një forcë që ta ndalonte në rrugën e tij. Zjarr i lëshonin sytë,

megjithëse dukej shumë i qetë. Ai shkonte në detyrë sikur po shkonte të kryente një punë të zakonshme. Nuk kishte rëndësi sa i madh ishte rreziku, për të nuk kishte ndalesë. E kishte pjekur mendimin, e kishte qartësuar plotësisht vetveten, ai do të ishte atje ku duhej, për të bërë atë që duhej, pa menduar për kërcënimet e rreziqeve të pranishme.

Luani për të kryer detyrat e di të furnizimit dhe të drejtimit shumë herë e shpesh e ka bërë rrugën e mundimshme e të rrezikshme Shqipëri – Kosovë. Rrugë pa rrugë, rrugë ku pas çdo hapi e pas çdo shkëmbi e druri të malit të priste tyta e ftohtë e pushkës së armikut, i cili ishte i vendosur të mos e lëshonte atdheun tonë që e kishte pushtuar. Prandaj edhe ishte i vendosur të vriste e masakronte çdo shqiptar që do të ngrinte dorën e armatosur për ta çliruar vendin. Por edhe ne ishim të vendosur ta zhdukim njëherë e përgjithmonë pushtuesin. E Luani ishte njëri nga ata që nuk ndalej. Kur dukej se ai akoma nuk ishte nisur, lajmëronte se ishte kthyer dhe e kishte kryer detyrën që kishte marrë mbi vete për ta kryer në Kosovë.

Por do të vinte një ditë, kur Luani bashkë me bashkëluftëtarë të tjerë nuk do të dojë të qëndrojnë më tej në procesin e organizimit e të furnizimit, por do të niset për të vepruar në Kosovë, duke pasur si synim të krijonte një njësit që do të vepronte në terrenin e Dukagjinit, për ta zgjeruar hapësirën ku dëgjoheshin krismat e pushkëve të UÇK-së. Ishte me shokë të zgjedhur e bashkë me të edhe vëllai i tij më i madh Ramushi, të cilët po i shkonin Kosovës për të dhënë sa më shumë nga vetja për ta çliruar.

Por armiku do të ishte aty përballë tyre. Luftëtarët do të ndodheshin përballë një formacioni të madh luftarak të armikut, të cilin nuk do të dëshironin ta ndeshnin në ato kushte. Por situata u krijua e tillë, sa që luftëtarët u detyruan të fillonin betejën e tyre. Ata e bënë luftën e tyre që zgjati disa orë, duke i shkaktuar humbje të ndjeshme armikut, por duke pësuar një humbje e dhimbje të madhe edhe për vete. Në atë betejë të pabarabartë do të bjerë në frontin e luftës për të qenë gjithnjë luftëtar i përjetshëm, luftëtarë dhe komandanti i madh i luftës Luan Haradinaj. Një humbje shumë e madhe për Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, për zonën e Dukagjinit, për bashkëluftëtarët, ashtu si dhe një dhimbje e madhe për familjen, për prindërit, për vëllezërit e gjithë të afërmit. E në atë betejë do të plagosen edhe Rafet Rama, Fehmi Lladrovci e Ramush Haradinaj, që përveç dhimbjes

për vëllain do të bartte edhe plagët.

Mund të thuhet se ajo betejë, ishte beteja e parë e zhvilluar në kufirin Shqipëri – Kosovë nga një formacion luftarak i UÇK-së. Mund të thuhet se Luani me veprën e tij e bëri luftën që aq shumë e dëshironte për ta parë Kosovën e Shqipërinë pa kufij midis tyre. Ai formacion që e bëri atë betejë që gjëmoi shumë, kishte në përbërje luftëtarë që pas daljes publike të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, do të bëheshin drejtues e udhëheqës me emër e disa prej tyre edhe do të binin në frontet e luftës për t'u bërë të përjetshëm. Për të arritur deri te kjo betejë e te lufta e madhe e UÇK-së dhe të çlirimi i Kosovës, Luani me vëllezër dhe shokë kishte vite që punonin e vepronin për ta ndryshuar fatin e Kosovës dhe kahren e fuqisë së kombit shqiptar. Jam krenar që kam ecur nëpër rrugët e veprimtarisë atdhetare dhe të luftës me viganë të tillë si Luan Haradinaj e luftëtarë të tjerë që kanë bërë vepra të përjetshme.

Luani kur ra për të kaluar në pedestalin kombëtar ishte vetëm 23 vjeçar, por ishte rritur aq shumë, sa të ishte njëri ndër udhëheqësit e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Luani i përkiste një familjeje me vlera të mëdha kombëtare. Familja Haradinaj ishte e njohur ndër kohë për qëndresën për atdhe e komb. Smajl Haradinaj (axha) që frymëzoi rininë me idealet kombëtare, me gjithë të bijtë e tij luftëtarë Nasimin e Agronin, dhe në përgjithësi kontributi i vëllezërve Haradinaj në luftën tonë çlirimtare kundër barbarisë serbe, shënon njërën ndër faqet më të ndritura të historisë sonë më të re, jo vetëm në Dukagjin. Familja e bacës Hilmi dhe nënës Rukie ishte e gjitha në shërbim të lirisë së Kosovës.

Luani i përket organizimit të njësiteve të para të luftës për liri në Dukagjin. Ai është evidencuar si pjesë e veprimtarisë luftarake bashkë me vëllanë e tij Shkëlzenin dhe me bashkëveprimtarë të tjerë qysh nga nëntori i vitit 1993. Prej asaj kohe, me vëllezërit e tij Ramushin, Shkëlzenin, Dautin dhe me shokët e idealit, si: Lahi Brahimaj, Agim Zeneli, Adrian Krasniqi etj., me tërë forcën e tij u përkushtua në organizimin e luftës për liri.

Luan Haradinaj i përket asaj pjese të burrave të Kosovës që quhen themelues të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Ishte udhëheqës dhe njeri i aksionit. Rënia e tij mbetet përjetësisht gur themeli për bashkimin e shqiptarëve në luftë për liri e bashkim kombëtar.

Lavdi jetës dhe veprës së Heroit të Kosovës, dëshmorit Luan Haradinaj!

LETËR DINAKE DHE PËRÇARËSE E ALBIN KURTHIT

Lufta e Trojës në Kuvendin e Kosovës: Lufta e Trojës që e fshiu Trojën nga harta gjeografike ndodhi për shkak të një femre, Helenës. Preteksti ishte se Parisi i Trojës rrëmbëu Helenën nga burri i saj Menelaus, mbret i Spartës. Troja mbeti e rrethuar për 10 vjet deri sa grekët futën ushtarë në një “Kalë Troje” që grekët ia dhuruan spartanëve që pastaj Agamemnoni e mori Trojën duke e shkatërruar Spartën. A ishte ngjarje e vërtetë apo pjellë e mitologjisë greke nuk dihet por se nga kjo ngjarje është ndërtuar miti për “Kalin e Trojës” që nënkupton pabesinë, dinakërinë dhe tradhtinë. Lenka Haxhiu, flet shqip dhe deklarohet shqiptare. As nuk është vet mbretëreshë e as nuk është gruaja e mbretit. Për dallim nga Helena nuk ka rrezik të rrëmbëhet nga askush. Madje, shumica nuk e duan por se ka shkaktuar shumë probleme. Si “mbretëreshë” e Kuvendit të Kosovës, e kurorëzuar nga Kurthi që po e keq - përdorë si “Kalë Troje” kundër opozitës dhe luftës për pushtet. Ndërkaq që kjo po e luan në përpikëri rolin e caktuar nga Kurthi, ndryshe është e mbaruar fare. Është e pabesueshme sa këmbëngulëse është Lenka që të bëhet “Helena” e Kuvendit të Kosovës. Këtu më nuk mund të flitet për dinjitet, reputacion, korrektësi, sinqeritet apo cilësime tjera që hyjnë në fushën e moralit, si themel i një njeriu të virtytshëm. Është pikërisht e kundërta! Po diçka mund të thuhet me siguri të madhe, Lufta e Trojës nuk mund të ndodhë në Kuvendin e Kosovës sepse mungojnë edhe preteksti si dhe konteksti, edhe forma si dhe përmbajtja. E vetmja lidhshmëri midis Luftës së Trojës dhe Kuvendit të Kosovës është “Kali i Trojës”.

Letra e Kurthit drejtuar Lumit të Xhikës: Deputeti dhe kryetari i LV-së, Albin Kurthi, pas zgjedhjeve të 9 shkurtit 2025 iu



Behxhet Sh . SHALA - BAJGORA

drejtua hajvanëve dhe hajvanatit me një porosi papnore, urbi et orbi se ai do ta formojë qeverinë dhe se ai do të jetë KM i Kosovës dhe se votat i ka të siguruar. Pas kësaj “homo sapiensët” e LV-së, në me krye rrencin e “trenit bullgar - Komandant pasulin” ia mbajtën zhagun Kurthit duke thënë se vota kanë sa të duash për faktin se kjo fitore nuk ishte dosido. Rrenc pas rrenci, mashtrues pas mashtrues! Ç’është e vërteta Kurthi u mundua t’i blejë votat por deri sot nuk ia doli. Për një gjë isha dhe jam i sigurt se Kurthi për asnjë çmim nuk e dorëzon pushtetin, e ka çështje të mbijetesës qëndrimin në pushtet, ai dhe shpura e tij. Nuk mund ta paramendojnë që të bien “nga kali, në gomar”, nga të gjithëpushtetshëm, në vdekatarë të rëndomtë. Pushteti ua jep statusin e sigurimit nga çdo ndjekje apo siguron pandëshkueshmërinë kurse humbja e pushtetit i bënë caqe të lehta për gjah, pëllumba prej argjili - balte. Nuk flitet këtu për parime politike apo morale ku patriotizmin e kanë shndërruar në kondom, për një përdorim.

Askush nuk donte të bashkëpunonte me Kurthin përveç Komandantit nga Livaxha, Nenad Rashiqit, Emilly Bronte - Rexhepi dhe Elbert Krasniqit. Edhe i damkosuri Damka. Acarimi ishte sidomos në raporte LV - LDK ku kjo e fundit, më parë do të takohej me bin Ladenin se me Albin bin Kurthin. AAK-ja kishte qëndrim të ashpër kundër Kurthit e jo kundër LV-së. PDK-ja kishte qëndrim jokomfrontues me LV-në dhe Kurthin, nuk përdori fjalë shpërfytyruese, nuk fyente por se refuzonte çdo koalicion me Kurthin. Mirëpo, kryetari i PDK-së bëri një veprim të mençur politikisht dhe strategjikisht, u takua me Kurthin, biseduan dhe nuk u pajtuan për asgjë. Topi mbeti aty ku ishte në fillim. Kurthi u bind se me Krasniqin dhe PDK-në nuk mund të manipulohet andaj iu kthye “dashurisë së vjetër - LDK-së”, që lehtësisht e pati mashtruar më herët, bashkë me kuislingen Vojsa Odmani duke e ndarë LDK-në në dysh. Kur luaneshat dalin për gjah, nuk i sulmojnë kafshët e fuqishme por saktësisht identifikojnë grupet e

cenueshme, si ato në moshë, ato me lëndime apo të porsalindurit. Është gjah që iu siguron një meny të begatë, pa iu nënshtruar ndonjë rreziku. Nëse përcillni ndonjë dokumentar të tillë në Netflix ku ka aksione paramilitari i LV-së, Teneqe Murati lehtë bindeni për këtë pohimin tim. LV-ja dhe Kurthi, të prirë nga përvoja, LDK-në e konsiderojnë grup të cenueshëm apo gjah të lehtë, prandaj Kurthi dërgon letra te LDK-ja sikur Balzaku dashnoreve të shumta. Kjo letra e fundit, për koalicion të mundshëm është për LDK-në, si “puthja e Judës”, dinake, përçarëse dhe denoncuese. Kurthi kurrë nuk ka pasur qëllim të bëjë koalicion me asnjë parti shqiptare përveç se në mesin e tyre ka kërkuar “Kalë Troje”. Me Listën Serbe publikisht ka refuzuar çdo bashkëpunim, për shkaqe “patriotike” në kohën kur për bisedime të sinqerta dhe konstruktive me LS-në e ka autorizuar Mimoza Kusarin, një seksere e papërsëritshme për kah dinakëria dhe mungesa e çdo skrupulli. Zemlakinja e zemlakut, Millan Radoiq. Letra dërguar Lumit të Xhikës

nga Albin Pusi, është letër krejtësisht antikombëtare, vardisëse deri në neveri, kundër UÇK-së, me qëllim të përjashtimit të krahut të luftës. Pse është dashur Albin Kurthi në letër të dërguar Lumit të Xhikës të theksojë se LV-ja është kundër koalicionit me PDK-në përveç se është një denoncim i ulët dhe përpjekje që t’i vardiset LDK-së duke e futur edhe këtë parti kundër luftës dhe UÇK-së. Korrekte do të ishte të kërkojë koalicion me LDK-në, pa e përmendur PDK-në, nëse LDK-ja e hanë, ia paftë qyqën e hajrit. Në rrethana normale edhe ky koalicion do të ishte normal, në rrethana që janë tash, ky koalicion e forcon shumë diktaturën e regjimit të Kurthit dhe e shkërmoq shumë LDK-në. Ashtu i shoh gjërat. Nga ky koalicion përfituesi më i madh do të ishte Vojsa Osmani duke siguruar edhe një mandat të shëtitjes nëpër botë, pa bërë asgjë. Ajo i fërkon duart edhe këmbët për këtë koalicion. Përveç Vojsa Osmanit, përfitues tjetër i madh do të ishte aktivisti i devotshëm i LV-së nga landi i Bavarisë e që në Kosovë është maskuar si ambasador, Jorn Rohde.

Konklava e Vatikanit dhe Kuvendi i Kosovës: A është rastësi apo profeci, më 7 maj 2025 në Vatikan mbahet Konklava (Kuvendi) i kardinalëve për ta zgjedhur papën pasi Franciskus e la këtë botë. Të njëjtën ditë konklava (Kuvendi) i deputetëve të Kosovës do të votojë për ta zgjedhur papeshën e Kuvendit të Kosovës, Lenka Haxhiu. Kur të del tymi i bardhë në Vatikan është lajm se u zgjodh Papa i Ri. Kur injoranca ta mund arsyen, është lajm se Lenka Haxhiu u zgjodh kryetare e Kuvendit. Në rastin më të butë të fjalës! Në këtë ditë të bekuar për Vatikanin dhe të mallkuar për Kosovën uroj që Barcelona dhe Arsenal të mos e kenë fatin e Lenkës! Forca Barça dhe Arsenal!

Haradinaj përuron lapidarin e Dëshmorëve dhe Martirëve në Pejë: E shenjtë është liria në këtë tokë



PEJË, 5 MAJ - Kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, në Ditën e Dëshmorëve qëndroi në Zahaq të Pejës, për ta përuruar lapidarin e dëshmorëve dhe martirëve, ku nderoi 138 dëshmorët e Pejës dhe të gjithë ata që ranë për liri dhe dinjitet kombëtar. Në “Facebook”, Haradinaj tha se liria në Kosovë është e shenjtë dhe do të jetojë për aq kohë që i qëndrojnë besnikë gjakut të derdhur për të. “Me rastin e 5 Majit, Ditës së Dëshmorëve të Kombit Shqiptar, pata nderin të jem

në Zahaq të Pejës, në përurimin e lapidarit të Dëshmorëve dhe Martirëve, ku nderuam 138 dëshmorët e Pejës dhe të gjithë ata që ranë për liri dhe dinjitet kombëtar, në të gjitha trevat dhe etapat e historisë sonë. Sa më shumë afrohej liria, aq më shumë shtoej intensiteti i luftës ndaj okupatorit. Në rrethinën e Istogut, trimat e Ushtrisë Çlirimtare luftonin deri në vetëmohim, duke i dhënë goditjet e fundit armikut. Po në këtë datë, 5 Maj 1999, në altarin e lirisë ra

edhe Muharrem Vuthaj nga Vrella, një luftëtar që mishëronte vlerat më të larta të trimërisë dhe dashurisë për atdheun. Liria në këtë tokë është e shenjtë dhe do të jetojë për aq kohë sa ne i qëndrojmë besnikë gjakut të derdhur për të. Heroizmi dhe sakrifica e Dëshmorëve të Kombit do të jenë gjithmonë udhërrëfyes në shtetndërtimin tonë dhe në forcimin e faktorit shqiptar si garantues i paqes, stabilitetit dhe zhvillimit në rajon”, ka thënë Haradinaj.

INVESTITORËT E HUAJ PËRBALLË BUROKRACISË DHE MUNGESËS SË PUNËTORËVE TË KUALIFIKUAR

PRISHTINË, 5 MAJ - Që nga viti 2020 kompania “Simtex”, me bazë në Zvicër, punëson dhjetëra punëtorë në Kosovë. Por edhe pas rreth 17 milionë eurosh investime, pronarët e “Simtex” shprehin pakënaqësi me pengesat në biznesbërje në Kosovë.

Menaxheri i kompanisë, Reshad Cej, thotë se institucionet shtetërore në Kosovë nuk kanë ofruar ndonjë ndihmë apo lehtësim për kompaninë. Ai madje thotë se çdo kërkesë apo procedurë has në vonesa të gjata nga institucionet. “Po jua jap vetëm një shembull: Kur kemi aplikuar për lejen e tensionit të lartë të energjisë elektrike, kemi pritur nëntë muaj për ta marrë. Kjo është një sfidë jashtëzakonisht e madhe dhe humbje për kompaninë”, thekson ai për “Radion Evropa e Lirë”.

Aktualisht me 150 punëtorë, kjo kompani eksporton prodhimet e saj të tekstilit në vendet e Bashkimit Evropian. Problemet, sipas Cejit, janë shtuar edhe më shumë pas liberalizimit të vizave, në janar të vitit 2024, për shkak të mungesës së fuqisë punëtore dhe ekspertëve të tekstilit. “Jemi të varur nga inxhinierë të huaj. Aktualisht, kemi 25 inxhinierë të tekstilit nga Turqia”, shprehet ai. Ai ankohe se punëtorët që i merr kompania dhe i trajnon për tri deri në gjashtë muaj, në fund e lënë kompaninë për të emigruar jashtë vendit. Ceji nuk është i vetmi që përballet me probleme të tilla.

Në çfarë sektorë bëhen investime të huaja direkte?

Në mesin e aktiviteteve ekonomike, sektori i patundshmërisë është vlerësuar më tërheqësi për investitorët e huaj. Nga gjithsej 856.3 milionë euro investime të huaja të realizuara vitin e kaluar, mbi 75 për qind janë investuar në patundshmëri.



Ish-ministri i Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, Ismet Mulaj, thotë se procedurat burokratike vazhdojnë të mbeten pengesë për investitorët edhe 17 vjet pas shpalljes së pavarësisë. Për të zgjidhur këtë problem dhe për të tërhequr më shumë investime të huaja, Mulaj propozon krijimin e një zyre të veçantë që do të përshejonte të gjitha shërbimet për bizneset e huaja.

Një zyrë e tillë, sipas tij, do ta zvogëlonte burokracinë dhe do ta përmirësonte imazhin e Kosovës si vend i sigurt dhe fitimprurës për investime. “Kërkesat e investitorëve të

huaj kalojnë nëpër procedura të shumta administrative, të cilat mund të zgjasin mbi dy vjet. Investitorët seriozë nuk kanë kohë të presin kaq gjatë. Për shembull, për të tërhequr një investitor të huaj në fushën e energjisë së ripërtëritshme, duhet të kalohen 28 procedura, dhe vetëm afati kohor minimal është dy vjet”, thotë Mulaj për “Radion Evropa e Lirë”.

Investimet e huaja në rritje, të përqendruara në patundshmëri

Pavarësisht prej këtyre sfidave, investimet e huaja në Kosovë janë shtuar në vitet e fundit. Sipas Agjencisë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA), këto investime arritën në mbi 856 milionë euro vitin e kaluar, nga 840 milionë euro sa ishin në vitin paraprak.

Nga të gjithë sektorët, më së shumti investime të huaja janë bërë në sektorin e patundshmërisë, sipas të dhënave të KIESA-s.

Fokusi në patundshmëri nuk

është gjë pozitive, sipas Mulajt. Ai beson se më e dobishme do të kishte qenë nëse investimet do të bëheshin në sektorë që krijojnë vende të reja pune apo nxisin zhvillim ekonomik. “Investitorët nga diaspora kryesisht po investojnë në blerjen e banesave, shtëpive dhe tokave”, thotë ai.

Me të pajtohet Kushtrim Ahmeti, nga Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë në Kosovë, i cili beson se investimet në patundshmëri nga diaspora ndodhin kryesisht për shkak të mungesës politikave lehtësuese për biznesbërje ose mosinformimit të investitorëve mbi sektorët potencialë për investim. Sipas Ahmetit, pasiguria e furnizimit me energji elektrike, situata e paqëndrueshme politike, trazirat e herëpashershme në veriun e Kosovës, procedurat burokratike dhe sundimi i paqartë i ligjit e bëjnë vendin më pak tërheqës për investime në prodhim apo aktivitete që do të kishin ndikim të drejtpërdrejtë në rritjen ekonomike. “Përmirësimi i mjedisit për investimet e huaja

mund të ndihmojë në uljen e shkallës së papunësisë, rritjen e prodhimit dhe eksporteve, si dhe reduktimin e numrit të punëtorëve të pakualifikuar në tregun e punës”, shprehet Ahmeti.

Shumica e investimeve të huaja në Kosovë vijnë nga shtetet ku është e përqendruar diaspora e Kosovës. Në vitin 2024 nga Gjermania janë investuar rreth 200 milionë euro, ndërsa nga Zvicra rreth 190 milionë euro.

Sipas Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, në Kosovë janë 13 388 biznese të regjistruara më pronarë të huaj. Prej tyre, 7 245 janë aktive.

Vetëm në tre muajt e parë të këtij viti janë regjistruar 167 biznese të reja që, sipas Ministrisë, tregun një trend pozitiv dhe interesim të vazhdueshëm nga investitorët e huaj për sektorë të ndryshëm.

Si sektorë të mirë për investime të huaja në Kosovë, ekspertët e ekonomisë theksojnë ato të energjisë së ripërtëritshme, teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK), agrokulturën dhe turizmin.

Agim Shahini: Kriza politike po fundos ekonominë, kërkojmë veprim urgjent!

PRISHTINË, 5 MAJ - Kryetari i Aleancës Kosovare të Bizneseve (AKB), Agim Shahini, ka shprehur shqetësimin e thellë dhe indignatën e plotë ndaj dështimit të njëmbëdhjetë me radhë për konstituimin e Kuvendit të Kosovës dhe formimin e institucioneve qeverisëse. Sipas Shahinit, kjo qasje e papërgjegjshme e partive politike dhe deputetëve po dëmton rëndë jo vetëm imazhin e Republikës së Kosovës brenda dhe jashtë vendit, por po

krijon edhe pasiguri të thellë institucionale dhe ekonomike. “Bizneset po përballen me pasiguri të madhe, mungesë të stabilitetit politik dhe pamundësi për të planifikuar e zhvilluar aktivitetet e tyre, ndërkohë që investitorët e huaj po hezitojnë gjithnjë e më shumë të angazhohen në tregun tonë. Kosova nuk ka luksin të humbasë kohë. Kjo krizë e zgjatur politike është barrë e rëndë për ekonominë, për qytetarët dhe për të ardhmen evropiane të vendit.



Deputetët dhe liderët politikë duhet të marrin përgjegjësitë e tyre kushtetuese dhe morale, t'i tejkalojnë interesat partiake dhe të veprojnë në interes të shtetit dhe të qytetarëve”, ka thënë Shahini.

Ai ka thënë se AKB-ja kërkon me urgjencë konstituimin e institucioneve dhe kthimin e vendit në binarët e stabilitetit dhe zhvillimit. “Mosveprimi i mëtejshëm do të ketë pasoja të pakthyeshme për ekonominë dhe të ardhmen e Kosovës si shtet funksional”, ka pohuar Shahini.

PERANDORËT ILIRË TË BIZANTIT



Pas ndarjes së Perandorisë Romake nga perandori romak Teodosi, në vitin 395, perandorët e Lindjes dhe të Perëndimit ishin të ndryshëm. Nuk ishte si më parë kur një perandor mund të qeveriste të gjithë Perandorinë

Bizantin thuhet se e themeloi një shqiptar, Konstandini, që më 1453 e pushtoi po një shqiptar tjetër për llogari të Perandorisë që përfaqësonte, otomane.

Më 476 Perandoria Romake e Perëndimit u pushtua nga fiset gjermanike. Kjo shënoi fundin e perandorisë së Perëndimit. Pas kësaj, e vetmja perandori mbeti ajo e lindjes e Konstandinopolit, që ruante ende gjuhën, titujt dhe traditën latine në qeverisje. Por, kjo vetëm në shekujt e parë.

Nga të dhënat e autorëve të asaj kohe, përsëri dalin figura që janë ilirë në krye të shtetit të Bizantit, që arritën ta bëjnë një perandori të vërtetë.

Pas shekullit të shtatë, është e vështirë të flasësh për origjinën e saktë të perandorëve të Bizantit, se popullsia u trazua nga dyndjet barbare sllavë dhe në Gadishullin ilirik ndryshoi struktura etnike.

Pra, flasim për perandorët shqiptarë të perandorisë së

Bizantit, deri aty sa kemi të dhëna historike. Shqiptarët arritën edhe këtu majat e pushtetit në sajë të aftësive të tyre ushtarake, sepse edhe këtu vazhdoi ajo traditë që filloi në Romë në shek. III-IV, që froni i takonte më të zotit, pra, kemi në marrjen e pushtetit meritokracinë, e cila për fat të keq nuk funksionon as sot.

Anastasi, 491-518

Historiani i Bizantit Joani Malala tregon se “Pas sundimit të Zenonit u bë perandor shumë i hyjnushmi Anastas Dikori nga Dyrrahu i Epirit të ri”. Pra, Anastasi ishte nga Durrësi. Para tij ishte në pushtet dinastia Izaure me të cilët luftoi shumë për fronin derisa i shkatërroi.

Gjatë kohës së qeverisjes së tij u ashpërsua lufta midis dy rrymave fetare. Këta ndaheshin në të gjelbërit, që përkraheshin nga Anastasi, dhe të kaltërit që predikonin ortodoksinë. Kjo

luftë fetare, desh i kushtoi fronin Anastasit, megjithatë, arriti ta shmangte në sajë të aftësive të tij intelektuale dhe ushtarake. Anastasi, gjatë qeverisjes së tij, arriti t'i kthejë perandorisë disa territore që i kishin pushtuar persët. Ai bëri disa ndërtime të rëndësishme në qytetin e tij të lindjes, Durrës, dhe ndërtoi një mur 75 km të gjatë nga deti Marmara në detin e Zi, për të mbrojtur Konstandinopolin nga dyndjet barbare, dhe nga sulmet e shteteve të tjera, që më vonë do të ishte shumë i dobishëm. Ai ngriti një sistem ekonomik të fortë dhe ndërmori reforma monetare duke i lënë shtetit rezerva të mëdha ari në buxhet kur vdiq.

Justini I, 518-527

Justini ishte me origjinë ilire nga Dardania. Prokopij Cezares te “Historia e Fshehtë” na tregon origjinën e tij kur thotë se “Kur Leoni ishte perandor në Bizant, 3 fshatarë të rinj ilirë Zimarhu, Ditivisti dhe Justini nga Bedriana, mbasi luftuan për një kohë të gjatë në atdheun e tyre me vështirësitë e varfërisë, duke dashur të shpëtonin prej tyre, vendosën të hynin në shërbim ushtarak. Ata u drejtuan në këmbë dhe arritën në Bizant me torba në krahë në të cilat kishin futur nga shtëpia vetëm bukë thatë. Ata u pranuan në ushtri dhe perandori i zgjodhi për roje të oborrit se kishin një trup të

mrekullueshëm”. Pasi u fut në ushtri, Justini u bë komandant i Gardës perandorake, dhe me zgjedhjen e ushtrisë e miratimin e popullit e Senatit u bë perandor. Kështu, nga një fshatar me një copë bukë thatë në torbë u bë perandor i fuqisë më të madhe ushtarake të botës së atëhershme. Justini nuk dinte shkrim e lexim, por u kujdes shumë që nipi i tij, Justiniani, të merrte të gjithë arsimimin e nevojshëm, dhe e afroi në pushtet sa që vetë gjallë.

Justini uli tensionin midis kishës së lindjes dhe të perëndimit duke hyrë edhe vetë në negociata. Në përgjithësi ishte tolerant për çështjet e fesë, pavarësisht se në perandori kishte shpërthyer një konflikt i madh fetar.

Justiniani I – i Madhi

Justiniani ishte nip i Justinut të I dhe lindi në Bedriana në Dardani. Vendit të cilin e rriti ai ia shpërbleu si asnjë perandor ilir më përpara. Kështu, ndërtoi qytetin e tij të lindjes dhe e rrethoi me mure të larta me qëllim që të mos prekej nga dyndjet barbare. Me shpenzimet e veta ndërtoi një ujësjellës madhështor në qytet që të kishte ujë në të gjitha stinët. Për atdheun nga vinte ndërtoi 157 kështjella që nga Danubi në Epir me qëllim që të siguronte këto territore nga dyndjet e popullsisë të ndryshme që kishin filluar prej

shekujsh. Është meritë e tij që një pjesë e madhe e territorit shqiptar shpëtoi nga dyndjet sllave.

Justiniani u martua me Teodorën, një femër e shturur që kishte nisur jetën si artiste, por që kur njohu Justinianin, ktheu rrugë, pasi u dashurua me të dhe filloi t'i përkushtojë perandorit dhe Zotit. Gruaja ishte partneria e tij në politikë, dhe një nga këshilltarët më të zonja që do ta shpëtonte atë në disa raste, madje edhe kur rrezikoi fronin.

Ëndrra e Justinianit në politikën e jashtme ishte që të ribënte edhe njëherë Perandorinë Romake, dhe kësaj ëndrrë i dedikoi pjesën më të madhe të jetës së tij. Ai kishte disa komandantë të zotë si Belisari dhe Naseri të cilët ndërmorën fushata ushtarake për të pushtuar territoret që kishte projektuar Justiniani. Kështu brenda një kohe të shkurtër ai pushtoi mbretërinë vandalëve në Afrikën veriore, Siçilinë, Napolin, Ravenën. Në Itali luftoi kundër ostrogotëve dhe kapi mbretin e tyre rob, ashtu si edhe mbretin e vandalëve. Pushtoi pjesën juglindore të gadishullit Iberik duke shkatërruar dhe aty mbretërinë gjermane. Por ndërkohë që ai ndërmerte fushata ushtarake në perëndim, barbarët sllavë po shkelnin tokat më të mira të perandorisë ato të Ilirisë, dhe pasi bënë një shekull fushata grabitëse tashmë, donin që të vendoseshin në këtë vend

patjetër. Ai nuk i pranoi t'i vendoste në Iliri, por në shekullin e VII perandori Herakël i vendosi sllavët në territoret ilire, në Kroaci dhe Slloveninë e sotme, pasi fiset me origjinë turke të quajtura bullgare, kishin hyrë në pjesën lindore të Ilirisë me forcë, më vonë erdhën edhe serbët që u vendosën në Danub në veri të Dardanisë. Enciklopedia Ruse e vitit 1954 pasqyron kufijtë e mbretërisë së Serbisë në fillim të shekullit të XIX, të cilat shtriheshin në veri të Nishit vetëm në Beogradin e sotëm dhe po aty pasqyrohet zgjerimi i Serbisë në kurriz të tokave etnike shqiptare. Nga njerëz që mezi nxirrnin kokën nga pylli, dalëngadalë sllavët u bënë zotër të pjesës më të madhe të Ilirisë duke e futur vendin në një periudhë errësire mesjetare dhe varfërie.

Justiniani, për të mos pasur probleme me perandorinë perse, nënshkroi me të një marrëveshje paqeje për 50 vjet. Në vitin 532, ai shtypi kryengritjen e Nikes, që ishte një luftë midis të kaltërve e të gjelbërve për çështje fetare, që lidheshin me pikëpamjet që kishte njëra palë për Zotin dhe tjetra. Justiniani, nuk mbajti nga asnjëra palë, gjë që e çoi në konflikt me të dyja palët, të cilat u bashkuan kundër tij. Ata shpallën perandor një ilir tjetër, nipin e Anastasit, dhe Justiniani u bë gati të largohej nga froni, por nuk e la Teodora dhe kështu me ushtri e diplomaci arriti ta shtypë rebelimin, dhe të forcojë pushtetin e vet.

Ai ndaloi shitblerjen e posteve në administratë, dhe kreu një

reformë administrative që e centralizonte pushtetin dhe e vinte nën kontrollin e tij. Në provinca ndau pushtetin civil nga ai ushtarak me qëllim që administratorët e tyre të mos kishin në dorë gjithçka dhe të bëheshin konkurentë për fronin perandorak me forcën e armëve. Rriti tregtinë duke hapur një rrugë të re për në Kinë që shmangte territoret e perandorisë perse, madje ai dërgoi agjentë në Kinë, të cilët e vodhën krimin e mëndafshit, pasi kinezët nuk ua jepnin, dhe ngriti një industri të madhe mëndafshi në Konstandinopojë dhe qytete të tjera.

Justiniani ishte iniciatori i një kodifikimi të madh të së drejtës romake duke parë se ajo nuk po i përshatej më marrëdhënieve të reja që ishin krijuar. Në fakt, e drejta romake ishte një e drejtë skllavopronare, por në kushtet e krishterimit skllavërit po liroheshin dhe filloi një lloj i ri skllavërimi që quhej kolonat e më pas feudalizëm. Kështu kur marrëdhëniet ekonomike kishin ndryshuar, duhej ndryshuar dhe ligji që rregullonte këto marrëdhënie. Në fakt, ishin bërë shumë ligje sepse çdo perandor nxirrte urdhëresat e tij, duke e bërë drejtësinë shumë konfuze, kështu që lindte nevoja e kryerjes së një seleksionimi të së drejtës për ta bërë atë sa më praktike. Për këtë ai ngarkoi një grup juristësh, të cilët kodifikuan të drejtën duke nxjerrë Corpus Juris Civilis, pra kodin e së drejtës civile. Pas një pune trivjeçare u bë një përmbledhje e çështjeve të së drejtës romake e quajtur Diageste, që ishte një përmbledhje e shkrimeve të

juristëve të vjetër romakë. Për ta studiuar studentët këtë të drejtë në shkollë u krijuan Institucionet. Ligjet që nxori vetë Justiniani gjatë qeverisjes së tij u quajtën Novela dhe ishin të vetmet në gjuhën greke. Kështu e drejta Skllavopronare iu përshtat një shoqërie të re. Ky kodifikim u ndikua nga idetë e reja të barazisë para ligjit, megjithatë kjo e drejtë i shërbente klasës së lartë, dhe perandori kishte një pushtet të pakufizuar mbi shtetin dhe shtetasit e tij pra ai ishte mbi çdo gjë. Kjo do të ishte dhe filozofia e mbretërve feudalë të mëvonshëm.

Ai ishte armik i paganizmit grek, dhe në vitin 529 mbylli Akademinë e Athinës ku predikohej akoma feja pagane. Në fakt, me grekët, perandorët e Bizantit janë sjellë shumë keq, sepse ata qenë popullsia e fundit e perandorisë që u kristianizuan ngaqë kishin pasur një traditë të fortë pagane dhe një numër të madh perëndish që s'ishte e lehtë t'i shkulje nga mendjet e njerëzve. Ai e mbrojti kishën e krishterë dhe i dhuroi prona të shumta. Ndërtoi kisha e manastire, ku mbi të gjitha dallonte kisha e Shën Sofisë në Konstandinopol, një vepër arti e klasit të parë që u kthye në xhami, e sot është muze. Kjo kishë apo xhami është ndërtuar në kodër në një sipërfaqe të madhe përballë detit, dhe qëndron edhe sot madhështore si përpara 1400 vjetësh.

Edhe pse kisha kishte Patriarkanën, ai qëndronte në krye të saj duke marrë pjesë në çdo konsil dhe kështu lidhi pushtetin fetar me atë civil. Ai ishte autoriteti më i lartë i

kishës së lindjes, dhe as para tij dhe as më pas nuk pati perandorë që ndikuan aq shumë te kisha. Që ta kishte mirë me Papatin ai duhet të dënonte të gjithë kundërshtarët fetarë të tij, që ishin rrymat fetare të lindjes, të cilat kundërshtonin doktrinën zyrtare të kishës si e pambështetur në Bibël, pra që mbështetej në fjalët e njerëzve të shenjtë, dhe jo në fjalët e Zotit. Megjithë masat që mori, ai kurrë nuk i mposhti dot këto rryma. Duke qenë se nuk ia dilte dot as me papën dhe as me rebelët fetarë në perandori, e mbante mirë herë me njërën palë e herë me tjetrën duke i kërcënuar kur ishte e nevojshme. Periudha e qeverisjes së Justinianit ishte periudha e fundit e lavdishme e Perandorisë Romake, se pas tij do të fillonte një periudhë e re në historinë e perandorisë. Ai ishte një nga perandorët më të mëdhenj të Bizantit, sepse i dha perandorisë edhe njëherë, për herë të fundit, territoret e perëndimit deri në Spanjë. Justiniani ishte iniciatori i kodifikimit të së drejtës romake, që sot është baza e kodeve civile e sistemit civil low në Europë dhe kudo në botë.

Justini II, 563-578

Pas vdekjes së Justinianit pushtetin e mori nipi i tij Justini, po ilir. Në kohën e qeverisjes së tij gjendja në vend u përkeqësua nga armiqtë e brendshëm e të jashtëm. Kështu, ai prishi marrëveshjen që kishte bërë Justiniani me persët për 50 vjet dhe nuk pranoi t'u paguante tributin vjetor. Lufta midis tyre u


zhvillua për Armeninë për të cilën kishin pretendime të dy palët.

Tiber Konstandini, 578-582

Gjatë qeverisjes së tij vazhdoi luftën me Persët për të ruajtur integritetin e perandorisë. Ai ishte një njeri shumë bujar dhe u kujdes për popullin e perandorisë. Kështu uli taksat dhe shpenzoi shumta të mëdha nga buxheti duke e shterur atë. Ai njihej si një perandor i mirë, dhe kur vdiq populli u hidhërua shumë.

Mauricio, 582-602

Maurici ishte një nga perandorët më të mëdhenj të Bizantit. Ai erdhi në fron pas vdekjes së Tiber Konstandinit dhe duhet të ketë qenë nga e njëjta dinasti ilire ose i afërm i tyre sepse nuk ka ndonjë reprezalje për të marrë pushtetin me forcë. Derisa perandorët filluan t'i linin trashëgimin djemve ose të afërmeve të tyre pa dyshim që ai ka qenë një nga të afërmit e perandorit paraardhës, sepse e mori pushtetin me qetësi të madhe, pasi kur ndërroheshin dinastitë perandorake bëheshin luftra disavjeçare, ashtu siç ndodhi me Mauricion më pas, që i rrëmbehet froni me luftë nga një gjeneral i quajtur Foka. Gjatë sundimit të tij arriti të bënte paqe me Persinë dhe i shkëputi asaj një pjesë të Armenisë, e cila kishte një pozitë gjeografike të favorshme për rrugët tregtare në lindje. Krijoi Egzarkatin e Ravenës në Itali, dhe të Kartagenës, të cilat





ishin pushtuar gjatë Justinianit. Ai uli taksat dhe kjo e afroi me popullsinë e vendit. Në testament i la njërit djalë Ravenën, dhe tjetrit Konstandinopolin, por në atë kohë, një gjeneral i ushtrisë së Danubit, gjysëm barbar, i quajtur Foka, organizoi një kryengritje kundër tij dhe e rrëzoi nga fronin. Foka vrau të pesë djemtë në sy të Mauricios, dhe pastaj atë vetë, kështu mori fund dhe sundimi i kësaj dinastie ilire.

Perandorët ilir të Bizantit qeverisën që nga viti 491 deri në vitin 602, pra për 111 vjet. Ata u dalluan për aftësitë e tyre ushtarake dhe politike në drejtimin e shtetit, duke i rikthyer lavdinë Romës, dhe Bizantit. Me këta perandorë Bizanti arriti kulmin e zgjerimit të tij, sidomos me Justinianin. Përveçse burra të zotë, ata qenë dhe njerëz që kontribuan në qytetërimin botëror me veprat e artit që ndërtuan.

A ka pasur perandorë të tjerë Bizanti me origjinë ilire?

Me dyndjet barbare filloi një epokë e errët për gjithë historinë e gadishullit Ilirik pasi ai u kthye në fushë lufte dhe dyndjeje në masë të popullsisë të stepave, të cilët dalëngadalë u bënë zotë të tokës së ilirëve. Kjo errësirë ishte e gjithanshme, si në jetën ekonomike dhe atë politike e kulturore, dhe nuk ka historianë që të kenë shkruar në këtë kohë për këtë rajon dhe për popujt e tij. Në fakt, duke qenë se pushteti në Bizant merrej me meritë, pra, ushtarakët më të zotë dilnin në drejtimin e perandorisë dhe deri në kohën kur flitet për gadishullin Ilirik, kemi pothuajse vetëm perandorë ilirë, patjetër që ka

pasur perandorë të tjerë sepse elementi Ilir dhe klasa aristokrate ushtarake ilire në Bizant, ishte tepër e fortë.

Dinastitë e Maqedonasve, Komnenëve, Dukasëve, Paleologëve dhe Katakuzhinëve

Meqë në Bizant gjuha greke ishte gjuhë zyrtare ashtu si latinishtja në perëndim, të cilat ishin gjuhë të kishave, disa studiues e quajnë Bizantin perandori greke. Kjo është e barabartë me atë, se meqë sot gjuha angleze është gjuhë ndërkombëtare, atëherë e gjithë bota ka qeveritarë anglezë dhe popujt e kulturës angleze. Pra, të thuash se Bizanti ishte perandori greke, është e njëjta gjë sikur të thuash se sot bota ka popuj dhe drejtues anglezë dhe është angleze.

Në revistën Monument të 2003 jepet një e dhënë tepër e rëndësishme. Në një mbishkrim të gjetur në Ravena që ka lidhje me peshkopin Felix, i cili i përkiste periudhës kur perandor ishte Filippicus 711-713 shkruhet: “Post mortem vero Justiniani levaverunt super se Pelasgi novum imperatorem (Felix-Ravenna, 1974, Bovini, p.212) që do të thotë se pas vdekjes së vërtetë të Justinianit (II) vendoset perandori i ri pellazg. Pra, autori e ka quajtur Filippicusin që qeverisi në 711-713 si pellazg, pra ilir që do të thotë se Bizanti vazhdon ende të qeveriset nga ilirët të cilët njihen nga romakët ende me emrin pellazgë, fakt që dëshmon edhe njëherë se ilirët ishin vetë pellazgët.

Në Bizant njihet një dinasti që quhet si dinastia maqedonase, e cila qeverisi nga viti 867 deri në shekullin XI. Këta

maqedonas nuk quhen as sllavë e as grekë por thjesht me emrin Maqedonas. Çfarë etniciteti kanë pasur? Po të kihet parasysh se në vitin 1912, ¼ e Maqedonisë etnike pellazgo-ilire e Aleksandrit dhe e Filipit, ishte e banuar nga shqiptarët mundet që kjo dinasti të ketë qenë nga familje feudale shqiptare.

Në shekullin XI në pushtet erdhi një perandor Bizantin i quajtur Roman Argjir. Aristidh Kola te libri “Arvanitët dhe prejardhja e grekëve” kur flet për disa familje shqiptare në shtetin grek, Argjirët i quan shqiptarë, por edhe po të shikosh edhe etimologjinë e mbiemrit është shqip Ar-gjiri. Kur flitet për Komnenët, Paleologët, thuhet se ata nuk ishin grekë, as sllavë por ishin të një kombësie tjetër. Cila ishte kjo kombësi tjetër kur dihet që ata kishin marrëdhënie të mira me shqiptarët?!

Në vitin 1056, në pushtet në Bizant vjen Isak Komneni nga aristokracia provinciale. Familjet feudale shqiptare kishin marrëdhënie me Komnenët dhe lidhje gjaku si Arianitët. Aristidh Kola jep disa fakte që qartësojnë disa origjinën e burrave të këtyre dinastive.

1 – Ai thotë se familja Vrionase ka pretenduar se është pasardhëse e Paleologëve sepse emri i tyre i vjetër ka qenë paleolog.

2 – Paleologët dhe Kataguzhinët me dekrete të posaçme thirrën shqiptarët që të vendosen në grupe prej mijëra vetësh në Peloponez. Çfarë i lidhte me shqiptarët që t’i merrnin me dekrete të posaçme dhe pse nuk e bënë për ndonjë etni tjetër?

3 – Konstandin Paleologu e çliroi Morenë me ushtri arbëreshe.

4 – Paleologët ishin perandorët që vendosën shqiponjën

simbolin e shqiptarëve në flamurin e shtetit të tyre, dhe po të shikosh flamurin e Bizantit në atë kohë me flamurin e Skënderbeut nuk ka asnjë ndryshim. Pse do e vendosnin këtë simbol po që se nuk do ta kishin në kulturën e traditën e tyre? Të njëjtën gjë bënë edhe perandorët ilirë të Romës të cilët, kur erdhën në pushtet, vendosën shqiponjën, të njëjtën gjë bëri Napolon Bonaparti kur erdhi në pushtet. Çfarë tregon kjo?

5 – Në 1358 prijësi shqiptar Karl Topia i ngriti arbëreshët në një kryengritje kundër Niqifor Angjelos, sepse ky ndau gruan që të martohej me të motrën e së vesë së Stefan Dushanit. Pse do ngriheshin në kryengritje pikërisht arbëreshët dhe jo grekët. Këtu nuk bëhej fjalë për fenë pasi të gjithë ishin ortodoksë, por bëhej fjalë për kombësinë sepse arbëreshëve nuk u ka pëlqyer që një arbëresh të lërë gruan arbëreshe për të marrë një sllave. Kjo do të thotë se në kundërshtim me çfarë thuhet te Shqiptarët, ka ekzistuar ndërgjegjja kombëtare, por shqiptarët e kanë përdorur për të tjerët.



6 – Kur ra Konstandinopoja dhe Paleologët po dorëzonin armët në Peloponez, arbëreshët, me Pjetër Bue Shpatën, u ngritën të ndalojnë këtë veprim të perandorit të tyre. Pse pikërisht arbëreshët dhe jo ndonjë komb tjetër? Sepse arbëreshët e kishin idenë e kombësisë më të zhvilluar se fqinjët, dhe ata i dolën në mbrojtje perandorit të etnisë së tyre. Shqiptarët duke qenë se i kanë qeverisur vetë perandoritë e mëdha, i kanë parë ato si shtete tërësisht të tyre.

7 – Në kohën që Konstandinopoli ra dhe paleologët po bëheshin gati që të dorëzoheshin, arvanitët

shpallën perandor Manuil Kadakuzhinin njëlloj siç bënte ushtria ilire me shekuj, që shpallte vetë perandorët që qeverisën Romën. Pse perandor Kataguzhinin dhe jo ndonjë tjetër?

Si konkluzion:

Perandorët që qeverisën Bizantin nga shekulli IX deri në shekullin XV, ishin nga Ballkani dhe jo nga territore të tjera të perandorisë. Sipas burimeve historike nuk ishin as grek dhe as sllavë madje, ka të dhëna që ata i urrenin shumë sllavët. Atëherë, çfarë ishin nga etniciteti? Sigurisht që kanë qenë shqiptarë, se vetëm tokat e shqiptarëve mbetën nën perandorinë Bizantine nga tokat e Ballkanit dhe fisnikëria feudale shqiptare e bënte karrierën e saj politike-ushtarake natyrisht te shteti i asaj, që në këtë rast ishte perandoria Bizantine. Pra, fisnikëria feudale shqiptare e shikonte pushtetin Bizantin si pushtet të shtetit të saj, prandaj dhe shqiptarët u shkëputën vonë nga Bizanti dhe perandoria Osmane, se kjo fisnikëri i drejtonte dhe qeveriste vetë këto perandori. Jan Klod Feveriali një njohës i mirë i historisë së mesjetës të Ballkanit tek libri “Historia më e vjetër e Shqipërisë” thotë gjithashtu se edhe mbreti i bullgarëve, Samueli ishte gjysëm shqiptar dhe gjysëm vllah”. Pra, ka të dhëna që shqiptarët vazhdonin të qeverisnin Ballkanin, ashtu siç kishin bërë prej shekujsh. Megjithëse të dhënat për këtë periudhën historike janë të pakta, mendoj se në bibliotekat e Vatikanit dhe në ato mesjetare të Bizantit, ka të dhëna që mund të dalin në dritë më vonë. /GazetaVotra/



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Javë vendimtare për Kosovën

PRISHTINË, 5 MAJ - Përfaqësuesja A e Kosovës në hendboll është grumbulluar të dielën mbrëmë në prag të ndeshjeve vendimtare për kualifikim në “Euro 2026”. Të enjten nga ora 20:15 në Pallatin e Rinisë dhe Sportit në Prishtinë, Kosova e pret Kombëtaren e Ishujve

Faroe. Ndërkohë të dielën e javës së ardhshme, më 11 maj, “dardanët” luajnë ndaj Holandës në ‘s-Hertogenbosch. Këto janë ndeshjet e fundit të fazës së fundit kualifikuese për Evropianin e vitit të ardhshëm. Pas katër ndeshjeve, Kosova i

ka tri pikë. Nga katër pikë i kanë Ukraina e Holanda, ndërsa Ishujt Faroe janë në vendin e parë me pesë pikë. Gara në grup është plotësisht e hapur. Të gjitha katër kombëtalet janë në garë për kualifikim në Evropian. Për Kosovën, kualifikimi do të ishte

sukses historik. Për të shpresuar në kualifikim, “dardanëve” u duhet fitorja të enjten me Ishujt Faroe. Me fitore gjasat për kualifikim janë të mëdha. I gjithë fokusi është te kjo ndeshje, ndërsa përkrahja e shikuesve është e domosdoshme.



Sonte vendoset finalist i parë

“Epoka e re”

Milano, 5 maj - Pas një ndeshjeje emocionuese javën e kaluar, gjigandët evropianë Inter dhe Barcelona takohen sërish sonte (e martë) për ta zhvilluar gjysmëfinalen e dytë në Ligën e Kampionëve, ku edhe do të mësohet finalist i parë i kësaj gare. Pasi luajtën ndeshjen e parë 3-3 në Spanjë, ata do të përballen sërish në “San Siro”, me Interin që synon të afrohet edhe një hap më shumë drejt titullit të katërt kontinental, ndërsa Barcelona kërkon trofeun e gjashtë. Në përballjen në mes të mbrojtjes më të fortë dhe sulmit më shpërthyes, u zhvillua një ndeshje kaotike në Katalonjë javën e kaluar. Interi e eliminoi Barcelonën në gjysmëfinale edhe në vitin 2010, kur fituan Ligën e Kampionëve me trajnerin Jose

Mourinho, duke mposhtur Bayernin në finale. Skuadra aktuale e Simone Inzaghit ka një moshë mesatare të ngjashme me atë të vitit 2010 dhe mbetet e fortë në shtëpi: janë të pamposhtur në 15 ndeshjet e fundit në “San Siro” në Ligën e Kampionëve, duke fituar 12 prej tyre. Historikisht, Interi ka fituar 9 nga 11 gjysmëfinale të fundit evropiane në shtëpi – një tjetër fitore do t'i çonte përballë Arsenalit ose PSG-së në finale. Megjithatë, forma e fundit nuk është perfekte: fitorja e zbehtë 1-0 ndaj Veronës të shtunën ndali një seri prej pesë ndeshjesh pa fitore, dhe ndonëse janë kampionët e Italisë, ata janë pas Napolit në garën për titullin e Serisë A. Ndërkohë, Barcelona e udhëhequr nga Lamine Yamal ka ambicie për tripletë. Pas fitores ndaj Real Madridit në finalen e Kupës së Mbretit dhe Superkupës së



FORMACIONET E MUNDSHME

Inter: Sommer; Bisseck, Acerbi, Bastoni; Dumfries, Barella, Calhanoglu, Mkhitarjan, Dimarco; Arnautović, Thuram.
Barcelona: Szczesny; Garcia, Araujo, Cubarsi, Martinez; De Jong, Pedri; Yamal, Olmo, Raphinha; Torres.

fituar më herët këtë sezon, ata janë gjithashtu në krye të La Ligës, me katër ndeshje të mbetura pas triumfit 2-1 ndaj Valladolidit. Barcelona ka

fituar 24 nga 30 ndeshjet e fundit – me humbjen e vetme ndaj Dortmundit në çerekfinale, ku rezultati ishte thuasht i vendosur që në

ndeshjen e parë - dhe sulmi i tyre është një makth për kundërshtarët. Barcelona me trajnerin Hansi Flick në stol – fitues i këtij turneu me Bayernin, kërkon ta arrijë finalen për herë të parë që nga viti 2015. Por historia nuk është në anën e tyre: ata kanë humbur katër gjysmëfinale të fundit jashtë fushe dhe kanë fituar vetëm dy ndeshje në këtë fazë larg shtëpisë, duke humbur plot 11 herë. Për më tepër, Barcelona ka fituar vetëm një nga gjashtë përballjet me Interin në “San Siro”, pjesë e një rekordi të dobët kundër skuadrave italiane: vetëm pesë fitore në 24 ndeshje në Itali në Ligën e Kampionëve. Interi pritët jetë pa golashënuesin më të mirë, Lautaro Martinez si dhe mbrojtësin Benjamin Pavard. Jules Kounde dhe dhe Alejandro Balde janë mungesat e Barcelonës për këtë ndeshje.

KV Ferizaj, kampion i Kosovës në Volejboll

FERIZAJ, 5 MAJ - Ferizaj ka shkruar histori në volejbollin e Kosovës duke fituar titullin e dytë të kampionit në histori të klubit, pas një finaleje emocionuese ndaj Dritës. Skuadra ferizajase triumfoi me rezultat 3:2 (22:25, 25:22, 22:25, 28:26, 10:15) në finalen e katërt të serisë, duke siguruar kështu fitoren e tretë dhe mbylljen e serisë së “play-

off”-it. Ferizaj këtë sezon realizoi një tripletë historike, duke fituar Kupën e Federatës, Kupën e Kosovës dhe tash edhe titullin e kampionit, në një vit të veçantë që përkon me 32-vjetorin e klubit. Ceremonia e medaljeve ishte një moment i veçantë për KV Ferizaj. Trofeun e kampionit e dorëzoi presidenti i FVK-së, Bahri Gjinovci, për kapitenin e



Ferizajt, Durim Rexhepi. Ndërsa medaljet e arta u ndanë nga sekretari i përgjithshëm Valon

Nikqi dhe nënkryetari i FVK-së, Valon Xhafaj, si dhe deputetja Arbnora Salihu. Medaljet e argjendta për Dritën u ndanë nga anëtarët e bordit të FVK-së, Antigone Veseli e Halime Fetahu, përzgjedhësi i Kosovës Lorik Ilazi, Halime Fetahu, drejtori i sportit në Gjilan, Kushtrim Zeqiri dhe Burim Rahimaj, si përfaqësues i klubeve Feniks. Me

këtë maratonë emocionuese përfundoi edhe edicioni 2024/25 në elitën e volejbollit të meshkujve. Federata e Volejbollit e Kosovës uron KV Ferizaj për titullin e kampionit dhe i përgëzon të gjithë lojtarët, stafin dhe tifozët për një sezon fantastik. FVK-ja e ka përgëzuar edhe Dritën për një finale të fortë dhe të denjë.


KOK-u ndan mbi 82 mijë euro për shpresat olimpike

PRISHTINË, 5 MAJ - Komiteti Olimpik i Kosovës (KOK) vazhdon të investojë në të ardhmen e sportit të Kosovës, duke i mbështetur financiarisht sportistët e rinj që konsiderohen shpresa olimpike për vendin. Në kuadër të përkushtimit për zhvillimin e sportit elitare dhe përgatitjet drejt Lojërave Olimpikë të ardhshme, KOK-u ka ndarë

mbi 82 mijë euro për 46 sportistë të rinj nga 18 federata sportive. Presidenti i KOK-ut, Ismet Krasniqi, ka thënë se qëllimi kryesor është të ketë sa më shumë mbështetje për sportistët, për atletët dhe për shpresat olimpikë. “Komiteti Olimpik i Kosovës ka vazhduar nga viti në vit ta rrisë mbështetjen e sportistëve, numrin e

bursistëve olimpikë apo shpresave olimpikë në këtë rast. Tashmë në këtë vit Komiteti Olimpik i Kosovës i mbështet 46 sportistë të rinj të cilat vijnë nga 18 federata sportive olimpikë që është një numër mjaft i madh besoj dhe synimi i Komitetit Olimpik është që sa më shumë të rritet numri që të ketë sa më shumë mbështetje për sportistët

tanë, për atletët tanë dhe për shpresat olimpikë. Pra, mbështetja e një sportisti për një muaj është 150 euro, që do të thotë një sportist do të fitojë 1 800 euro në vit. Në përgjithësi, 46 sportistë Komiteti Olimpik i Kosovës do t'i mbështesë me 82 mijë e 800 euro”, ka thënë Krasniqi. Krasniqi gjithashtu bëri me dije se nga muaji shtator i



këtij viti KOK-u do ta fillojë mbështetjen edhe të bursistëve olimpikë të cilët kanë synimin kryesor për përgatitjet për normal olimpikë “Los Angeles 2028”.

Warriorsi fiton në ndeshjen e shtatë dhe kalojnë tutje në ‘play-off’

SAN FRANCISCO, 5 MAJ - Golden State Warriors u kualifikua në çerekfinalet e “play-off” të NBA-s, pasi mposhti Houston Rocketsin me rezultatin 4-3 në një seri të shkëlqyer. Çelësi ishte ndeshja e shtatë e luajtur këtë mëngjes kur Golden State fitoi jashtë fushës me rezultatin 103:89. Warriorsi e

hapi mirë ndeshjen dhe pati një epërsi minimale pas çerekut të parë. Edhe para pushimit dominoi, kështu që pjesa e parë përfundoi me rezultatin 51:39. Rocketsi tregoi shenja jete në çerekun e tretë kur e ngushtoi diferencën, por kjo ishte e tëra çfarë mundi të bënte në ndeshje, pasi Golden State e

rriti përsëri gazin në fund dhe arriti lehtësisht një fitore të madhe në “vrimën” e Houstonit. Lojtari më i mirë i Golden States ishte Hield me 33 pikë, ndërsa Curry pati 22 pikë dhe 10 asistime. Thompsoni me 24 pikë ishte më efektiv i te Houstoni me një lojë të shkëlqyer nga Sengun i cili

kishte 21 pikë dhe 14 kërcime. Golden State do të luajë kundër Minnesota Timberwolves në çerekfinale, dhe ndeshja e parë e serisë do të luhet të mërkurën. Ndryshe, mbrëmë u luajt ndeshja e parë e çerekfinaleve, në të cilën Indiana Pacers mposhti Cleveland Cavaliersin me



rezultatit 121:112 dhe kështu mori kryesimin në seri.

Almir Aganspahiq, ‘Ylli i javës’ në Superligë

PRISHTINË, 5 MAJ - Federata e Futbollit e Kosovës dhe sponsori i Superligës, Albi Mall, vazhdojnë ta japin çmimin “Ylli i javës”. Ky çmim për javën e 32-të në Albi Mall Superligë i është dhënë futbollistit të SC Gjilanit, Almir Aganspahiq. Vlerësimi i më të mirit të javës është bërë nga Komisioni i Veteranëve të Futbollit, në përbërje të Skënder Kapra, Rifat Nasufi dhe Agim Xhakolli. Ky komision vendosi që çmimi “Ylli i javës” për xhiron e 32-të t’i takojë Aganspahiqt, i cili shënoi “hat-trick” në fitoren me përmbysje të SC Gjilanit në ndeshjen kundër FC Feronikeli



74, me rezultat 3:2. Pasi mori këtë çmim, Aganspahiq u shpreh i lumtur që u vlerësua më i miri i javës: “Së pari dua t’i

falënderoj bashkëlojtarët dhe stafin për ndihmën e tyre që të arrij këtë çmim. Ishte një ndeshje shumë emocionuese. Gjatë gjithë lojës ishim në disavantazh, por në pjesën e dytë u treguam më ofensivë, më agresivë dhe arritëm të shënojmë tre gola”. “Jam shumë i lumtur për këtë, veçanërisht për dy golat e parë si dhe për golin vendimtar në sekondat e fundit të ndeshjes. Ende jemi në luftë, ende po luftojmë për objektivat tona. Po luftojmë për vendin që na çon në Evropë dhe do ta japim maksimumin për ta arritur atë”, ka deklaruar për faqen zyrtare të FFK-së.

Pas 20 vjetësh, Alexander-Arnold largohet nga Liverpooli

LIVERPOOL, 5 MAJ - Trent Alexander-Arnold tashmë është pjesë e historisë së Liverpoolit. Klubi “i kuq” ka bërë me dije zyrtarisht vendimin e mbrojtësit, i cili është kërkuar nga Real Madridi, për ta lënë “Anfield”-in pasi kontrata e tij përfundon. “Trent Alexander-Arnold ka informuar Liverpoolin për dëshirën e tij për ta lënë klubin këtë verë pasi të skadojë kontrata aktuale”, ka njoftuar Liverpooli në llogarinë e tij të “X”. Vetë Alexander-Arnold e ka dhënë këtë lajm në rrjete sociale: “Pasi kam kaluar 20 vjet te Liverpool Football Club, ka ardhur momenti të konfirmoj se do të largohem në fund të sezonit. Pa dyshim, ky është vendimi më i vështirë që kam marrë në jetën time. E di që shumë njerëz kanë pyetur pse ose janë ndierë të zhgënjyer për faktin që nuk kam folur ende për këtë, por gjithmonë ka qenë qëllimi im të përqendrohem në më të mirën për ekipin: të siguroj titullin e 20 të Premierë Ligës”, ka thënë mbrojtësi anglez. “Ky klub ka qenë jeta



ime, bota ime, për 20 vjet. Që nga akademia e deri tani, mbështetja dhe dashuria që kam ndier nga të gjithë, brenda dhe jashtë klubit, do të më shoqërojnë përjetë. Do të jem gjithmonë mirënjohës. Por nuk kam njohur asgjë tjetër, dhe ky vendim përfshin përvojë e një sfide të re, daljen nga zona ime e rehatisë dhe përmirësimit tim si profesionist dhe si person. Kam dhënë gjithçka çdo ditë që kam qenë në këtë klub dhe shpresoj

që të ndiheni se kam shpërblyer çdo moment të kohës që kam kaluar këtu”, ka shtuar ai dhe i ka falënderuar të gjithë ata që ka punuar përgjatë këtyre 20 vjetëve. “Prej zemrës i falënderoj të gjithë: trajnerët, përfaqësuesit, bashkëlojtarët, stafin dhe tifozët tanë të pabesueshëm, për këto 20 vjet. Kam pasur fatin t’i jetoj ëndrrat e mia këtu. Dashuria ime për këtë klub nuk do të vdesë kurrë”, ka përfunduar Alexander-Arnold.

SHKURT

Finalja e Kupës zhvillohet më 21 maj

Ka ndryshuar data e finales së Kupës së Kosovës në futboll. Finalja e madhe do të luhet në mes të Prishtinës dhe Llapit, dy skuadrat që kanë siguruar një biletë për finale dhe synojnë fitimin e trofeut. FFK-ja kishte paraparë që finalja të luhet më 14 maj, por data ka ndryshuar. Tanimë dy skuadrat, si Llapi ashtu dhe Prishtina, i kanë informuar adhuruesit e tyre se ndeshja finale është shtyrë për një javë dhe do të luhet më 21 maj. Finalja në mes të Prishtinës dhe Llapit luhet me fillim nga ora 20:00 në stadiumin “Fadil Vokrri” në kryeqytet.

Istogu në finale të plejofit

Istogu nuk ka lejuar befasi dhe është kualifikuar në finale të plejofit në Superligën e Kosovës në hendboll në konkurrencë të femrave. Istogu në gjysmëfinale shënoi dy fitore ndaj Shqiponjës së Gjakovës. Fitoren e dytë, 43:31, e arriti të dielën pasdite në Gjakovë. Që në nismë mysafirët realizuan seri të golave për të udhëhequr 10:2. Më pas istogaset mbajtën epërsi bindëse deri në fund të ndeshjes. Me 14 gola, më efikasja tek Istogu ishte Suzana Ujkiq. Nëntë i realizoi Dijana Ujkiq e shtatë Nihed Limem. Dhjetë gola për Shqiponjën i shënoi Alma Nivokazi. Gjashtë i kishte Rosa Silva Ghabrielly. Ndeshjen e parë gjysmëfinale në Banjë, Istogu e kishte fituar 29:21. Në finale të plejofit, Istogu përballlet me Samadrexhën. Në ndeshjen e parë dhe ndeshjen e tretë eventuale, Istogu do të jetë vendas. Istogu është kampion në fuqi, ndërsa një javë më parë e fitoi Kupën e Kosovës.

Raspadori: I kemi edhe tri finale për të shkuar te titulli

Ndeshjet e fundjavës së kaluar konfirmuan Napolin në krye të renditjes së Serisë A, me +3 pikë karshi Interit. Fitorja 1-0 ndaj Lecces ishte e rëndësishme për skuadrën e trajnerit Antonio Conte, që tani i duhet të fitojë tri sfidat e radhës për t’u shpallur kampione. Protagonist i suksesit të fundit ishte sulmuesi Giacomo Raspadori, që me golin e tij i dha tri pikët skuadrës: “E dimë që jemi në fund të sezonit. Kanë mbetur edhe tri ndeshje. Tani duhet të bëjmë një hap me ndeshjen tjetër”. “Ka gola që mbahen mend dhe janë të rëndësishme, por ajo që mbetet është puna që bëjmë çdo ditë për të fituar ndeshje si kjo. Duhet ta kuptojmë se janë edhe tri takime, por ndeshja tjetër mbetet gjithnjë më e rëndësishmja”, ka shtuar Raspadori. “Duke ditur presionin që kishim, gjëja më e rëndësishme ishte të fitonim dhe ia dolëm mbanë. Soliditeti ynë fillon nga puna që bën i gjithë ekipi. Kur të gjithë luajnë mirë, presioni është më i lehtë për ne”, ka deklaruar Raspadori.

Fitore e dyfishtë e McLarenit, Verstappenit humbësi më i madh në Miami

Oscar Piastri i McLarenit fitoi Çmimin e Madh të Miamit, të gjashtin nga 24 garat e sezonit të Formulës 1, përpara shokut të skuadrës Lando Norris në pistën e Miamit. Duke u nisur nga pozicioni i tretë, australiani pati një betejë të

madhe deri në xhiron e fundit me britanikun, ndërsa George Russell i Mercedes zuri vendin e tretë. Kjo ishte fitorja e tretë radhazi e Piastrius dhe e katërta në përgjithësi në gjashtë garat e para, ndërsa Norrisi fitoi sprintin në Miami

të shtunën. Edhe pse nisi i pari, kampioni i botës me Red Bullin, Max Verstappen, përfundoi i katërti dhe është ndoshta humbësi më i madh i garës. Ai u tejkalua nga të dy McLarenët në një garë që shumë e konsideruan si më të

mirën e sezonit deri më tani. Rastësisht, piloti që nisi nga pozicioni i parë nuk ka arritur të fitojë që nga debutimi i garës në vitin 2022 në Miami. Piastri kryeson renditjen e përgjithshme me 16 pikë më shumë se Norrisi (131-115

pikë), Verstappenit ka 99 pikë në vendin e tretë, ndërsa McLarenit është bindshëm i pari midis konstruktorëve. Gara e radhës e sezonit është Çmimi i Madh i Emilia - Romagna në Imola të Italisë, i planifikuar për 18 maj.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Gordana Rakovic B.I. “Privatno Preduzeae Milenijum” ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 810367343 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da Gordana Rakovic B.I. “Privatno Preduzeae Milenijum”, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 810367343 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited Gordana Rakovic B.I. “Privatno Preduzeae Milenijum”, has come to the decision to quit its business: 810367343 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



Prishtinë, 05.05. 2025

NJOFTIM PUBLIK

Shoqëria „SVB ENERGY“ SH.P.K., me numër Unik Identifikues 812074532 me adresë: Rr. „20 Qershori“ pn, Komuna e Istogut Republika e Kosovës, në përputhje me dispozitat e Nenit 13 të Rregullës Nr. 03/2022 për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Projekteve të Energjisë, me datë 13.01.2025 ka dorëzuar në Zyrën e Rregullatorit për Energji (ZRRE) aplikacionin për marrje të Autorizimit dhe për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga panelet solare me kapacitet të instaluar prej 3 MW ZK Sinajë, Komuna e Istogut, Republika e Kosovës.

Shoqëria „SVB ENERGY“ SH.P.K., për projektin solar me kapacitet të instaluar prej 3 MW ZK Sinajë, Komuna e Istogut, me rastin e aplikimit, ka dorëzuar në ZRRE dëshmitë për marrje të AUTORIZIMT siç janë:

- Pëlqimin Mjedisor Nr.2763-2/24 dt. 30.05.2024 të lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.
- Pëlqimin nr. 11-351-241-23 dt. 22.11.2023 të lëshuar nga Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mjedis e Komunës së Istogut.
- Vendimin për Leje Ndërtimore Numri i Lëndës: Nr. 11-351-25250/111 të datës 15.10.2024 për “Ndërtimin e Parkut të Energjisë Solare Fotovoltaike me kapacitet prej 3 MW, ZK Sinajë, të lëshuar nga Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mjedis e Komunës së Istogut.
- Pëlqimin Elektroenergjetik Nr. 19361 dt. 20.12.2024 të lëshuar nga KEDS SH.A.
- Dëshmi mbi të drejtat pronësore (Kontratat për shfrytëzimin e tokës);
- Deklaratën për shitjen e energjisë;
- Deklarimet financiare;
- Dëshmi për posedimin e 10% të vlerës së investimit
- Kontratën për Inxhinieri, Prokurim dhe ndërtim (EPC)
- Studimi i fizibilitetit teknik dhe financiar,
- Plani i Biznesit; dhe
- Plani Dinamik i Realizimit.

Aplikuesi ka dorëzuar edhe kërkesat administrative sipas aplikacionit dhe ka dorëzuar deklaratën që, energjia e prodhuar nga ky projekt do të shitet bazuar në çmimet e tregut.

Njoftohen të gjitha palët e interesuara që vërejtjet e tyre eventuale lidhur me këtë aplikacion, mund ti paraqesin në ZRRE brenda 8 (tetë) ditësh nga data e publikimit të këtij njoftimi në adresën elektronike: skender_rugova@hotmail.com, arber.lubishtani@elen-ks.com dhe LEGAL-LECENSING@ero-ks.org

Qasja në dosjen e Aplikimit, për të cilat Aplikuesi ka lejuar qasje, mundësohet për aq sa e lejon legjislacioni për Qasje në Dokumentet Publike.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Guri” SH.P.K. me seli në Gjilanë, pronar Xhabir Ymeri ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 810273590 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Guri” D.O.O. Gnjlane, Xhabir Ymeri donelo odluku o prestani rada sa nrb. 810273590 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Guri” L.L.C. with headquarters Gjilanë, Xhabir Ymeri has come to the decision to quit its business: 810273590 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Elmira Kurpalaj nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e shkollë së mesme të mjekësisë “Hysni Zajmi”, Gjakovë.
- Sadri Krasniqi nga Xërxa, shpall të pavlefshme dëftesën e plotë nga klasa 1-8 të SH.F.M.U “Hamëz Thaqi”, Xërxe.
- Drelona Krasniqi nga Damjani i Gjakovës shpall të pavlefshme dëftesën e plotë nga klasa 1-5 të Sh.F.M.U “Kongresi i Manastirit”, Damjan Gjakovë.
- N.T.P. Idi Trade me seli në Prishtinë, shpall të [pavlefshme numrin certifikatën e biznesit me numër fiskal: 600190805.
- Shaip Hodaj shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore 8 vjeçare në Ortakoll Prizren.
- Betim Katana shpall të pavlefshme 4 dëftesat dhe diplomën QK “11 Marsi” Prizren.
- Fitnete Neziri shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu “Ekrem Rexha” Prizren.
- Gezim Kosova shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu “Motrat Qiriaz” Prizren.
- Ensar Butuc shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - IX shfmu “Motrat Qiriaz” Prizren.
- Laokont Bytyqi shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.
- Syla Hodaj B.I. shpall të pavlefshme numrin e biznesit me nr.811142562 të lëshuar nga ATK.
- Leotrim Qevani shpall të pavlefshme dëftesën e plotë shfmu “Hamëz Cena” Damjan Gjakovë.
- Ari Mamusha nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e klasës 10,11,12 dhe diplomën e Gjimnazit “Hajdar Dushi”, Gjakovë.
- Lirigzon Morina nga Senoci i Rahovecit shpall të pavlefshme dëftesat e klasës 10,11,12 dhe diplomën e shkollës së mesme profesionale “Selajdin Mullaabaz-Mici”, Rahovec.
- Fadil Dujaka nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Sh.M.Teknike “Nexhmedin Nixha”, Gjakovë.
- Besart Bardhi nga Tropoja e Shqipërisë shpall të pavlefshme dëftesën e klasës 12 dhe diplomën e lëshuar nga Sh.M.Teknike “Nexhmedin Nixha”, Gjakovë.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCES, TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT
AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRITUR
AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Nr: 786/1
Datë: 05.05.2025

SHPLLJE KONKURSI

Për regjistrimin e kandidatëve të gjeneratës së shtatë për nivelin e 5-të, të kualifikimit “Këshilltarë për Karierrë” në Qendrën e Kompetencës – Prizren

1. Kushtet e përgjithshme për regjistrimin e kandidatëve për regjistrimin e kandidatëve për nivelin 5 sipas Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve (KKK), në Qendrën e Kompetencës në Prizren,

Të drejtë aplikimi kanë:

1.1Kandidatët, Individë që punojnë në sektorin e arsimit dhe punesimit publik dhe privat (mësimdhënës, stafi i qendrave për karrierë, këshilltarët në zyret e punësimit, kompanitë e rekrutimit, ofruesit e trajnimeve);

1.2Kandidatët të cilët kanë përfunduar shkollimin e mesëm të lartë, shkollimin universitar (niveli 4 i kualifikimit ose më lartë).

1.3Kandidatët të cilët e kanë mbaruar arsimin jashtë Kosovës, obligohen ta bëjnë nostrifikimin, barasvlerësimin e diplomave dhe dëftesave në MASHTI dhe pastaj të konkurrojnë për regjistrim.

2. Ofrimi i kualifikimit

Baza e ofrimit të kualifikimit është Qendra e Kompetencës në Prizren si Institucion i akredituar nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve (AKK)

3. Përfitimet për kandidatët

Të gjithë kandidatët të cilët me sukses e përfundojnë këtë kualifikim, do të pajisen me certifikatë të nivelit V për “Këshilltarë në karrierë” sipas standardeve të AKK

4. Kreditë

Kualifikimi për “Këshilltarë në karrierë” zgjat një 240 orë mësimore – gjashtë javë trajnimi, ku sipas KKK Kualifikimi Kombëtar Profesional (D) me 12 Kredi të Arsimit dhe Aftësimi Profesional.

5. Paga për kualifikim

Sigurimi i cilësisë së kualifikimit bëhet nga AKK dhe AAAPARr. Të gjithë kandidatët të cilët pranohen për këtë kualifikim janë të obliguar që në afat prej 3 ditëve para se të fillojnë ligjëratat, të paguajnë shumën prej 450 (katër qind e pesëdhjetë) Euro.

6. Dokumentet e nevojshme për konkurim

Kandidatët për të konkuruar për regjistrim në kualifikimin e nivelit 5, “Këshilltarë në karrierë” duhet të paraqesin këto dokumente:

- ✓ Aplikacionin e cila merret Qendrën e Kompetencës Prizren;
- ✓ Kopja e letërnjoftimit
- ✓ Diplomën e shkollimit të mesëm të lartë,
- ✓ Diplomë të shkollimit universitar,
- ✓ CV
- ✓ Diploma dhe cetifikata tjera
- ✓ I gjithë dokumentacioni duhet të prezantohet si kopje ndërsa origjinalet për verifikim i sjellin vetëm kandidatët të cilët do të pranohen.

7. Afati i paraqitjes së dokumenteve, vendi dhe shpallja e rezultateve

Paraqitja e dokumenteve bëhet prej datës 02 Maj 2025 deri 08 Maj 2025

Paraqitja e dokumenteve bëhet në Qendrën e Kompetencës Prizren, Lagjja Dardania pn, 20000 Prizren.

Lista e kandidatëve të pranuar shpallet më 13 Maj 2025

Pagesat bëhet para se të filloj trajnimi me datë 14-15-16 Maj 2025

Kthimi i dokumenteve për kandidatët, të cilët nuk janë pranuar do të bëhet pas shpalljes së rezultateve.

Kandidatët e refuzuar në bazë të kriterëve për regjistrim kanë të drejtë që brenda 24 orëve, nga koha e shpalljes së rezultateve të paraqesin ankesë në Qendrën e Kompetencës Prizren

8. Kriteret e regjistrimit


Përparësi kanë kandidatët, Individë që punojnë në sektorin e arsimit dhe punesimit publik dhe privat (mësimdhënës, stafi i qendrave për karrierë, këshilltarët në zyret e punësimit, kompanitë e rekrutimit, ofruesit e trajnimeve);

9. Kuotat për pranim të kandidatëve

Do të pranohen gjithsejt 15 kandidat për grup.

10. Fillimi i trajnimit

Pjesa e pare e trajnimit fillon 19 Maj – 30 Maj 2025
Pjesa e dytë e trajnimit fillon 09 Qershor – 20 Qershor 2025
Pjesa e tretë e trajnimit fillon 30 Qershor – 11 Korrik 2025



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Cje Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjeipuneshejte

RESTAURANT



SWISS

TAVERNA



Tel: +377 45 400 156  +386 49 848 553

PRISHTINË

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992





ROYAL CROWN

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Ermbotelladaora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1906

Columbus, Georgia, USA
Since 1906 0.5L